

### Përmbledhje

Ekonomia e Kosovës në tremujorin e parë 2015 shënoi rritje vjetore prej 1.6 përqind, ndërkohë që në dy tremujorët pasues është shënuar përshpejtim i rritjes ekonomike (4.8 përqind rritje në TM2 dhe 4.0 përqind në TM3 2015) (ASK, 2015). Vlerësimet e BQK-së për vitin 2015 sugjerojnë rritje ekonomike prej 3.5 përqind, krahasuar me rritjen prej 1.2 përqind në vitin 2014. Ekonomia e Kosovës është karakterizuar me deflacion prej 0.5 përqind në vitin 2015, krahasuar me inflacionin prej 0.4 përqind në vitin paraprak.

Spektori fiskal gjatë vitit 2015 u karakterizua me rritje të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore. Sa i përket të hyrave, është shënuar rritje më e lartë e të hyrave vendore, përderisa në kuadër të shpenzimeve, rritja e kategorisë së pagave e mëditjeve dhe subvencioneve e transfereve ka ndikuar që shpenzimet e buxhetore të shënojnë rritje. Bilanci buxhetor shënoi deficit prej rreth 110.2 milionë euro që është për 22.9 përqind më i ulët krahasuar me vitin 2014.

Spektori i jashtëm është karakterizuar me rritje të deficitit të llogarisë rrjedhëse dhe kapitale, që kryesisht i atribuohet rritjes së deficitit në llogarinë e mallrave dhe rënies së shënuar në bilancin pozitiv të llogarisë së shërbimeve dhe të ardhurave parësore dhe dytësore. Eksporti mallrave shënoi rritje prej 0.2 përqind, përderisa importi shënoi rritje prej 3.8 përqind. Aktiviteti ekonomik në vitin 2015 është mbështetur edhe nga dy burime të rëndësishme të rritjes ekonomike në vend, remitencat dhe IHD-të.

Kreditë e sektorit bankar gjatë vitit 2015 përshpejtuan ritmin e rritjes, duke shënuar normë vjetore të rritjes prej 7.3 përqind (4.2 përqind në vitin 2014). Spektori i bujqësisë, sektori i prodhimit dhe sektori i shërbimeve financiare, përfaqësuan sektorët me rritjen më të lartë të kredive të pranuar, gjë që paraqet zhvillim të rëndësishëm në mbështetjen e zhvillimit ekonomik të vendit. Po ashtu, viti 2015 u karakterizua me rënie të normës së interesit në kredi, gjë që pritet të ketë rol të rëndësishëm në lehtësimin e qasjes në financimin bankar. Depozitat shënuan normë të rritjes prej 6.5 përqind (3.6 përqind në vitin 2014) duke ndryshuar trendin ngadalësues të ndjekur gjatë viteve të fundit.

Spektori bankar vazhdoi të përmirësojë cilësinë e portofolit kreditor. Norma e kredive jopërformuese u zvogëluar në 6.2 përqind (8.3 përqind në dhjetor 2014). Niveli kapitalizimit të sektorit bankar shënoi përforsim të mëtutjeshëm, përderisa edhe pozicioni i likuiditetit qëndroi në gjendje të kënaqshme.

Më përshpejtim të aktivitetit dhe përmirësim të performancës financiare u karakterizua edhe sektori mikrofinanciar. Rritje të aseteve shënoi edhe sektori i sigurimeve, megjithëse performanca financiare e këtij sektori vazhdoi të jetë e brishtë si rezultat i thellimit të humbjes gjatë vitit 2015. Spektori pensional shënoi rritje të ngadalësuar si rezultat i ngadalësimit të rritjes së arkëtimeve të kontributeve të reja si dhe ndikimit negativ që kishin zhvillimet në tregjet financiare ndërkombëtare në kthimin nga investimet e fondeve pensionale. Me gjithë këto zhvillime, kthimi nga investimet vazhdoi të jetë pozitiv.

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

## PËRMBAJTJA

<b>PËRMBLEDHJE</b>	<b>i</b>
<b>Eurozona dhe Ballkani Perëndimor</b>	<b>04</b>
<b>Ekonomia e Kosovës</b>	<b>05</b>
Sektori Real	05
Sektori Fiskal	08
Sektori i Jashtëm	09
Sistemi Financiar	11
Sektori Bankar	11
Sektori Pensional	23
Sektori i Sigurimeve	24
Sektori Mikrofinanciar	26
Tregu i Letrave me Vlerë	33

## GRAFIKËT DHE TABELAT

Figura 1. Norma e kreditimit ndërbankar EURIBOR dhe norma e rifinancimit e ECB-së	04
Figura 2. Rritja reale e PBB-së	05
Figura 3. Norma e inflacionit	06
Figura 4. Lëvizja e çmimeve të komponentëve kryesorë	06
Figura 5. Indekset e çmimit të konsumit, prodhimit dhe importit	06
Figura 6. Lëvizja e çmimeve të importit	07
Figura 7. Lëvizja e çmimeve të prodhimit	07
Figura 8. Regjistrimi i bizneseve	07
Figura 9. Struktura e ndërmarrjeve të reja	08
Figura 10. Eksportet, importet dhe bilanci tregtar	09
Figura 11. Remitencat	10
Figura 12. Struktura e investimeve të huaja direkte	11
Figura 13. Asetet e sistemit financiar	11
Figura 14. Asetet e sektorit bankar	12
Figura 15. Ecuria e kredive dhe depozitave	13
Figura 16. Kreditë e ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare	13
Figura 17. Kreditë sipas sektorëve ekonomik	13
Figura 18. Ndryshimi vjetor i kredive sipas sektorëve ekonomik	14

Figura 19. Kreditë sipas afatit të maturimit -----	15
Figura 20. Depozitat -----	16
Figura 21. Struktura e depozitave -----	16
Figura 22. Struktura e depozitave sipas maturimit -----	17
Figura 23. Depozitat e afatizuara -----	17
Figura 24. Norma mesatare e interesit në kredi dhe depozita -----	17
Figura 25. Norma mesatare e interesit në kreditë e ndërmarrjeve -----	18
Figura 26. Norma mesatare e interesit në kredi, sipas maturimit -----	18
Figura 27. Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomik -----	19
Figura 28. Norma mesatare e interesit në kreditë e ekonomive familjare -----	19
Figura 29. Norma mesatare e interesit në depozita -----	20
Figura 30. Norma mesatare e interesit në depozitat për ndërmarrje -----	20
Figura 31. Norma mesatare e interesit në depozitat për ekonomitë familjare -----	21
Figura 32. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit bankar -----	22
Figura 33. Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar -----	22
Figura 34. Treguesit e kualitetit të portfolios kreditore -----	22
Figura 35. Ndryshimi vjetor i gjithsej kredive dhe kredive joperformuese -----	23
Figura 36. Asetet e sektorit pensional -----	23
Figura 37. Asetet e sektorit të sigurimeve -----	24
Figura 38. Primet e pranuar dhe dëmet e paguara -----	25
Figura 39. Treguesit e profitabilitetit të sektorit të sigurimeve -----	26
Figura 40. Asetet e sektorit mikrofinanciar -----	26
Figura 41. Struktura e aseteve të sektorit mikrofinanciar -----	27
Figura 42. Kreditë ndaj ekonomive familjare sipas maturitetit -----	27
Figura 43. Kreditë e sektorit mikrofinanciar sipas sektorëve ekonomik -----	28
Figura 44. Rritja e kredive të sektorit mikrofinanciar ndaj ndërmarrjeve -----	28
Figura 45. Kreditë ndaj ndërmarrjeve sipas maturitetit -----	29
Figura 46. Lizingjet e sektorit mikrofinanciar -----	29
Figura 47. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar -----	30
Figura 48. Norma mesatare e interesit në kredi -----	31
Figura 49. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar -----	31
Figura 50. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar -----	32
Figura 51. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë -----	33
Figura 52. Normat e interesit të letrave me vlerë të Qeverisë sipas maturimit -----	34
Tabela 1. Rritja reale vjetore e PBB-së -----	04
Tabela 2. Treguesit e zgjedhur makroekonomik -----	36

## SHKURTESAT:

ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CAR	Treguesit e Mjaftueshmërisë së Kapitalit ( <i>angl. Capital Adequacy Ratio: CAR</i> )
CHF	Franku Zvicërran ( <i>angl. Swiss Franc: CHF</i> )
CPI	Indeksi i Çmimeve të Konsumit ( <i>angl. Consumer Price Index: CPI</i> )
EJL	Evropa Juglindore
EUR	Valuta Euro ( <i>angl. Euro currency</i> )
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
GBP	Poundi Britanik ( <i>angl. The Pound Sterling</i> )
IHD	Investimet Huaja Direkte
IPI	Indeksi i Çmimit të Importit ( <i>angl. Index Price Index: IPI</i> )
NPL	Kreditë Jopërfomuese ( <i>angl. Non-Performing Loans: NPL</i> )
NRER	Norma Reale Efektive e Këmbimit
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
ROAA	Kthimi Mesatar në Asete ( <i>angl. Return on Average Assets: ROAA</i> )
ROAE	Kthimi Mesatar në Kapital ( <i>angl. Return on Average Equity: ROAE</i> )
RWA	Asetet e Peshuara ndaj Rrezikut ( <i>angl. Risk Weighted Assets: RWA</i> )
USD	Dollari Amerikan ( <i>angl. United States Dollar</i> )
WEO	World Economic Outlook

## Eurozona dhe Ballkani Perëndimor

Eurozona gjatë vitit 2015 u karakterizua me rritje të aktivitetit ekonomik. Norma reale e rritjes ekonomike në vitin 2015 ishte 1.5 përqind, krahasuar me normën e rritjes prej 0.9 përqind të shënuar në vitin 2014, gjë e cila flet për tendencë rikuperimi të ekonomive të eurozonës (tabela 1).

Tabela 1. Rritja reale vjetore e PBB-së

Përshkrimi	2012	2013	2014	2015
Eurozona	-0.8	-0.3	0.9	1.5
Gjermania	0.6	0.4	1.6	1.5
Franca	0.2	0.7	0.2	1.2
Italia	-2.8	-1.7	-0.4	0.8
Austria	0.8	0.3	0.4	0.8
Spanja	-2.1	-1.2	1.4	3.1
Greqia	-6.6	-3.9	0.8	-2.3

Burimi: FMN, WEO, Tetor 2015


Rritja e ekonomike në eurozonë gjatë vitit 2015 u mbështet kryesisht nga kërkesa e brendshme, sidomos nga konsumi i ekonomive familjare. Kontribut të rëndësishëm në rritjen e konsumit kishte edhe rritja e fuqisë blerëse të konsumatorëve që i atribuohet rënies së nivelit të përgjithshëm të çmimeve e sidomos rënies së çmimeve të naftës. Megjithatë, ngadalësimi i ekonomisë së Kinës dhe ekonomive tjera në zhvillim u reflektuan në rënie të kërkesës së jashtme, duke shkaktuar kështu rënie të kërkesës për eksportet e eurozonës.

Sipas Eurostat, eurozona u karakterizua me normë mesatare vjetore të inflacionit prej 0.1 përqind në tremujorin e katërt të vitit 2015. Shkalla e inflacionit gjatë vitit 2015 ka qenë vazhdimisht e ulët ndërsa në vitin 2016, çmimet pritet të kenë tendencë rritëse. Sipas FMN-së, norma e inflacionit në eurozonë në vitin 2016 pritet të jetë 1.0 përqind, që megjithatë

është nën objektivin e BQE-së për të mbajtur normën e inflacionit në rreth 2.0 përqind. Rritja graduale e shkallës së inflacionit pritet të nxitet kryesisht nga ndikimi i politikës lehtësuese monetare të BQE-së në kërkesën e përgjithshme në eurozonë.

BQE vazhdoi të mbajë të pandryshuar normën bazë të rifinancimit gjatë vitit 2015. Megjithatë, lansimi i programit të gjerë stimulues që nga marsi i vitit 2015 ka ndikuar në rënien e normave 1 mujore dhe 12 mujore të interesit të kreditimit ndërbankar Euribor. Në TM4 2015, normat 1 mujore të Euribor kanë rënë në mesatarisht -0.15 përqind nga -0.09 përqind në TM3 2015. Në anën tjetër, normat mesatare për periudhë 12 mujore kanë shënuar rënie në mesatarisht 0.09 përqind në TM4 2015, nga mesatarja prej 0.17 përqind në TM3 2015.

Figura 1. Norma e kreditimit ndërbankar EURIBOR dhe norma e rifinancimit e ECB-së



Burimi: Euribor (2016) dhe ECB (2016)

Performanca e aktivitetit ekonomik në Ballkanin Perëndimor gjatë vitit 2015 vlerësohet të ketë shënuar përmirësim. Përforcimi i kërkesës së jashtme si rezultat i rikuperimit gradual të eurozonës, forcimi i konsumit privat dhe rritja e kreditimit kanë mbështetur aktivitetin ekonomik në vendet e Ballkanit Perëndimor. Sipas vlerësimeve të FMN-së,

shtetet e Ballkanit Perëndimor shënuan rritje mesatare të PBB-së prej 2.5 përqind në vitin 2015. Mali i Zi, Maqedonia dhe Kosova vlerësohet se u karakterizuan me një normë më të lartë të rritjes ekonomike prej 3.2 përqind secila, përderisa Serbia vlerësohet se shënoi rritjen më të ulët prej 0.5 përqind.

Ngjashëm me eurozonën, vendet e Ballkanit Perëndimor në vitin 2015 u karakterizuan me presione të dobëta inflacioniste, ndikuar kryesisht nga kërkesa e brendshme ende e dobët dhe çmimet e ulëta të mallrave në tregjet ndërkombëtare. FMN-ja ka vlerësuar se norma mesatare e inflacionit në vitin 2015 ishte 0.9 përqind. Shqipëria vlerësohet se u karakterizua me shkallën më të lartë të inflacionit prej 2.2 përqind, pasuar nga Mali i Zi dhe Serbia me 1.7 përkatësisht 1.6 përqind, ndërsa Maqedonia dhe Kosova u karakterizuan me norma të ulëta të inflacionit prej 0.1 përqind përkatësisht -0.5 përqind.

Norma e këmbimit të euros kundrejt valutave kryesore gjatë vitit 2015 është zhvlerësuar. Ndaj dollarit amerikan euro ka shënuar rënie për 16.6 përqind, frankës zvicerane 12.2 përqind, sterlinës britanike 9.3 përqind, lekut shqiptar 0.2 përqind, ndërsa është forcuar ndaj dinarit serb dhe lirës turke me rreth 3.0 përqind.

## Ekonomia e Kosovës


### Sektori Real

Bazuar në indikatorët makroekonomik, vlerësohet se ekonomia e Kosovës në vitin 2015 është karakterizuar me rritje të aktivitetit ekonomik. Sipas të dhënave të ASK-së, ekonomia e Kosovës shënoi rritje prej 1.6

përqind në TM1 2015, ndërsa në TM2 2015 është shënuar rritje dukshëm më e lartë me normë prej 4.8 përqind. Ritmi i përshpejtuar i rritjes së aktivitetit ekonomik ka qenë i pranishëm edhe në TM3 2015, kur normale reale e rritjes së PBB-së ishte 4.0 përqind.

Për tërë vitin 2015, vlerësimet e BQK-së sugjerojnë se norma reale e rritjes së PBB-së ishte 3.5 përqind, e gjeneruar kryesisht nga kërkesa e brendshme (figura 2).

Figura 2. Rritja reale e PBB-së, në përqindje




\*Të dhënat për vitin 2015 paraqesin parashikimin e BQK-së  
Burimi: ASK (2015)

Sipas vlerësimeve të ASK-së, investimet deri në shtator shënuan rritje prej rreth 9.2 përqind (4.7 përqind rënie në periudhën e njëjtë të vitit 2014), ndërsa konsumi shënoi rritje prej 1.2 përqind (3.8 përqind rritje në periudhën e njëjtë të vitit 2014). Sektorët që shënuan rritjen më lartë ishin sektori i furnizimit me energji elektrike, gaz, ujë (16.4 përqind), sektori hotelierisë dhe restoranteve (15.3 përqind), ndërtimtaria (10.7 përqind) dhe tregtia (4.5 përqind). Sektorët që shënuan rënie ishin sektori i administrimit publik (4.9 përqind) dhe shërbimet tjera (1.5 përqind).

Rritja e kërkesës së brendshme vlerësohet se ka ndikuar në rritjen e importit dhe, rrjedhimisht, në rritjen e deficitit të llogarisë rrjedhëse. Ndërsa, llogaria financiare e bilancit të pagesave është përmirësuar, kryesisht si rezultat i rritjes së investimeve të huaja direkte.

Niveli i çmimeve në Kosovë, shprehur nëpërmjet indeksit të çmimeve të konsumit (angl: Consumer Price Index: CPI), në vitin 2015 është karakterizuar me deflacion prej 0.5 përqind, krahasuar me inflacionin prej 0.4 përqind në vitin 2014 (figura 3).

Figura 3. Norma e inflacionit, ndryshimi vjetor në përqindje




Burimi: ASK (2016)

Në rënien e nivelit të përgjithshëm të çmimeve kontribuuan kryesisht çmimet e shërbimeve arsimore të cilat shënuan rënie për 22.6 përqind, transporti që shënoi rënie të çmimeve për 7.5 përqind dhe çmimet e shërbimeve të restoranteve dhe hoteleve të cilat shënuan rënie për 2.1 përqind. Rënia e çmimit të shërbimeve arsimore i atribuohet vendimit të qeverisë për zbritjen e pagesës për 50 përqind për studentët e universiteteve publike, vendim i cili është aplikuar me fillimin e vitit akademik në tetor të vitit 2014, ndërsa rënia e çmimeve të shërbimeve të transportit i atribuohet rënies së çmimit të derivateve të naftës.

Në anën tjetër, çmimet e pijeve alkoolike dhe duhanit u rritën për 6.5 përqind, si dhe çmimet e strehimit, ujit, rrymës, gazit dhe lëndëve tjera djegëse shënuan rritje për 1.6 përqind. Me rritje prej 0.4 përqind u karakterizuan edhe çmimet e ushqimit dhe pijeve joalkoolike të cilat përfaqësojnë rreth 40.9 përqind të shportës së konsumatorit kosovar (figura 4).


Figura 4. Lëvizja e çmimeve të komponentëve kryesorë, ndryshimi vjetor në përqindje



Burimi: ASK (2016)

Lëvizja e çmimeve në Kosovë është e ngjashme me lëvizjen e çmimeve në tregjet ndërkombëtare si pasojë e varësisë së lartë të ekonomisë së Kosovës nga importet. Kjo tregohet edhe nga sjellja e ngjashme e indeksit të çmimeve të importit dhe indeksit të çmimeve të konsumit në Kosovë (figura 5).


Figura 5. Indekset e çmimeve të konsumit, prodhimit dhe importit



Burimi: ASK (2016)

Çmimet e importit<sup>1</sup> deri në shtator të vitit 2015 kundrejt periudhës së njëjtë të vitit paraprak shënuan rënie mesatare prej 0.6 përqind. Çmimet e produkteve minerale (kryesisht naftës dhe derivateve të saj), të cilat janë kategoria kryesore e indeksit të çmimeve të importit, shënuan rënien më të lartë, pasuar nga çmimet e plastikës, metalet bazë si dhe mjetet e transportit. Në anën tjetër, çmimet e produkteve bimore dhe pajisjet e makinerisë shënuan rritjen më të lartë të çmimeve, pasuar nga shtazët e gjalla dhe produktet e tyre (figura 6).


Figura 6. Lëvizja e çmimeve të importit, ndryshimi vjetor në përqindje



Indeksi i çmimeve të prodhimit deri në shtator 2015 shënoi rritje mesatare vjetore prej 3.5 përqind. Rritja e çmimeve të prodhimit ishte më e theksuar te çmimet e prodhimit të produkteve kimike, pastaj çmimet energjisë elektrike, gazit, avullit dhe furnizimit me ajër të kondicionuar, çmimet e prodhimit të drurit dhe produkteve të drurit. Në anën tjetër, rënia e çmimeve të prodhimit më së shumti ishte evidente te prodhimi i produkteve metalike, prodhimi i lëkurës dhe produkteve nga lëkura, rënia e


çmimeve të prodhimit të letrës dhe produkteve të letrës (figura 7).

Figura 7. Lëvizja e çmimeve të prodhimit, ndryshimi vjetor në përqindje



Sa i përket regjistrimit të ndërmarrjeve, është shënuar rritje e numrit të ndërmarrjeve të regjistruara dhe po ashtu rritje e numrit të ndërmarrjeve të mbyllura. Numri i ndërmarrjeve të reja të regjistruara në vitin 2015 ishte 9,833, që paraqet 429 ndërmarrje më shumë se sa në vitin paraprak, ndërsa u mbyllën 2,205 ndërmarrje apo 534 ndërmarrje më shumë se sa në vitin paraprak (figura 8).

Figura 8. Regjistrimi i bizneseve, jo kumulative




Edhe gjatë vitit 2015 numri më i madh i ndërmarrjeve të regjistruara ishte në sektorin e tregtisë me 2,903 ndërmarrje të reja, pasuar nga sektori i prodhimitarisë

<sup>1</sup> Bazuar në kalendarin e publikimeve të ASK-së indeksi i çmimeve të importit dhe prodhimit për tremujorin e katërt të vitit 2015 do të publikohet me 11 përkatësisht 14 mars 2016.



me 1,047 ndërmarrje, hotelerisë me 1,018 ndërmarrje dhe bujqësisë me 945 ndërmarrje (figura 9). Kundrejt periudhës së njëjtë të vitit të kaluar, te sektori i bujqësisë është shënuar rritja më e lartë e ndërmarrjeve të regjistruara prej 271 ndërmarrje më shumë, pasuar nga tregtia ku është shënuar rritje prej 89 ndërmarrjeve si dhe sektori i prodhimit i cili ka shënuar rritje të ndërmarrjeve të regjistruara prej 69 sosh më shumë se sa në vitin paraprak. Ndërsa, në sektorin e ndërtimit janë regjistruar 50 ndërmarrje më pak krahasuar me vitin paraprak, në hoteleri 16 ndërmarrje më pak dhe në transport 10 ndërmarrje më pak.

Figura 9. Struktura e ndërmarrjeve të reja



### Sektori Fiskal

Të hyrat buxhetore<sup>2</sup> në vitin 2015 arritën vlerën bruto prej 1.49 miliardë euro. Nëse zbriten 35.7 milionë euro kthime të TVSH-së dhe tatimeve tjera nga Administrata Tatimore e Kosovës dhe Dogana e Kosovës, atëherë të hyrat buxhetore shënuan vlerën neto prej 1.46 miliardë euro, që paraqet një rritje

vjetore prej 9.3 përqind. Shpenzimet buxhetore<sup>3</sup> arritën vlerën prej 1.57 miliardë euro që paraqet rritje vjetore prej 6.2 përqind krahasuar me vitin paraprak. Rrjedhimisht, gjatë vitit 2015, buxheti i Kosovës regjistroi bilanc buxhetor prej rreth -110.2 milionë euro krahasuar me bilancin buxhetor prej -143.0 milionë euro në vitin 2014.

Sa i përket strukturës së të hyrave buxhetore, vërehet rritje e të hyrave të mbledhura nga tatimet vendore të cilat arritën vlerën bruto prej 332.8 milionë euro. Nëse zbriten kthimet e administratës tatimore në vlerë prej 28.8 milionë euro, atëherë të hyrat neto nga tatimet vendore shënuan rritje prej 11.5 përqind dhe arritën vlerën neto prej 304.0 milionë euro. Të hyrat e mbledhura nga tatimet kufitare arritën vlerën neto prej 944.9 milionë euro që janë për 8.8 përqind më të larta se në vitin 2014. Të hyrat jo-tatimore arritën vlerën prej 188.1 milionë euro apo 9.8 përqind më shumë se sa në vitin paraprak.

Sa i përket shpenzimeve, pagat e mëditjet dhe subvencionet e transferet shënuan rritje krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ndërsa shpenzimet kapitale dhe mallrat e shërbimet shënuan rënie. Investimet kapitale, të cilat përfaqësojnë rreth 25.8 përqind të gjithë shpenzimeve, ishin më të ulëta për 1.8 përqind krahasuar me vitin paraprak dhe arritën vlerën prej 404.0 milionë euro. Shpenzimet qeveritare për mallra dhe shërbime kanë shënuar rënie për 0.8 përqind dhe kanë arritur vlerën prej 204.2 milionë euro. Në anën tjetër, shpenzimet qeveritare për paga dhe mëditje kanë shënuar rritje prej 8.2 përqind dhe kanë arritur vlerën 524.8 milionë

<sup>2</sup> Në kuadër të të hyrave primare nuk janë përfshirë të hyrat nga huamarrjet, të hyrat nga privatizimi, pranimet nga grantet e përcaktuara të donatorëve dhe pranimet nga depozitat në mirëbesim.

<sup>3</sup> Në kuadër të shpenzimeve primare nuk përfshihen pagesat e borxhit, pagesat nga grantet e përcaktuara të donatorëve dhe pagesat nga depozitat në mirëbesim.

euro. Subvencionet dhe transferet po ashtu kanë shënuar rritje për 16.0 përqind dhe kanë arritur vlerën 418.9 milionë euro.

Borxhi publik, në dhjetor 2015, ka arritur në 748.9 milionë euro që është për 28.5 përqind më i lartë krahasuar me borxhin publik në dhjetor 2014. Si përqindje e PBB-së, borxhi publik ka arritur në rreth 12.98 përqind nga 10.63 përqind sa ishte në vitin paraprak. Kjo rritje e borxhit publik i atribuohet kryesisht rritjes së borxhit të brendshëm prej 47.3 përqind (i cili ka arritur në 377.8 milionë euro), ndërkohë që edhe borxhi i jashtëm ka shënuar rritje të konsiderueshme prej 13.7 përqind duke arritur në 371.2 milionë euro. Përderisa në vitet e kaluara borxhi publik dominohej nga borxhi i jashtëm, në fund të vitit 2015 borxhi i brendshëm kishte pjesëmarrje më të lartë (50.4 përqind) në gjithsej borxhin publik.


### **Sektori i Jashtëm**

Deri në nëntor të vitit 2015, deficitin e llogarisë rrjedhëse dhe kapitale ka shënuar vlerën prej 469.9 milionë euro, krahasuar me deficitin prej 393.9 milionë euro sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Kjo rritje e deficitit të llogarisë rrjedhëse dhe kapitale i atribuohet rritjes së deficitit në llogarinë e mallrave dhe rënies së shënuar në bilancin pozitiv të llogarisë së shërbimeve, të ardhurave parësore dhe të ardhurave dytësore. Deri në nëntor të vitit 2015, deficitin në tregtinë e mallrave u karakterizua me një rritje vjetore prej 1.2 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, përderisa suficitin në tregtinë e shërbimeve ishte më i ulët për 2.0 përqind. Gjithashtu, bilancet pozitive të të

ardhurave parësore dhe dytësore ishin më të ulët për 25.0 përkatësisht 1.3 përqind.

Eksporti i mallrave në vitin 2015 arriti vlerën prej 325.3 milionë euro, që përkon me një rritje vjetore prej 0.2 përqind (10.4 përqind rritje në vitin 2014) (figura 10)<sup>4</sup>. Rritja e eksportit të mallrave në vitin 2015 kryesisht i atribuohet rritjes së eksportit të plastikës dhe gomës, produkteve ushqimore si dhe rritjes së eksportit të produkteve minerale. Si pasojë e rënies së çmimeve në tregjet ndërkombëtare të metaleve kryesore që Kosova eksporton, eksporti i metaleve bazë shënoi rënie.

Figura 10. Eksportet, importet dhe bilanci tregtar, në milionë euro



Burimi: ASK (2016)

Importi i mallrave në vitin 2015 arriti në 2.6 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 3.8 përqind. Në kuadër të importit të mallrave, me rritje u karakterizua importi i produkteve ushqimore, metaleve bazë, plastikës dhe gomës dhe importi i mjeteve të transportit. Si rezultat i rritjes më të shpejtë të importit të mallrave krahasuar me eksportin gjatë vitit 2015, shkalla e mbulueshmërisë së importeve me eksporte është zvogëluar nga 12.8

<sup>4</sup> Burimi i të dhënave për eksportin dhe importin e mallrave në Kosovë është ASK, që është dhe prodhues zyrtar i këtyre statistikave.


përqind sa ishte në vitin 2014 në 12.5 përqind në vitin 2015.

Bilanci në tregtinë e shërbimeve shënoi vlerën prej 313.0 milionë euro deri në nëntor të vitit 2015 (319.5 milionë euro në periudhën e njëjtë të vitit 2014).<sup>5</sup> Eksporti i shërbimeve deri në nëntor të vitit 2015 shënoi rritje vjetore prej 2.6 përqind, duke arritur vlerën prej 712.4 milionë euro. Në të njëjtën periudhë, vlera e importit të shërbimeve shënoi rritje prej 6.5 përqind dhe arriti vlerën prej 399.4 milionë euro. Në kuadër të shërbimeve të eksportuara, shërbimet e udhëtimit u karakterizuan me rritje vjetore prej 9.4 përqind deri në nëntor të vitit 2015, përderisa kategoria e shërbimeve kompjuterike, informative dhe të telekomunikacionit si dhe kategoria e shërbimeve të biznesit u karakterizuan me rënie prej 27.1 përkatësisht 19.4 përqind. Sa i përket importit të shërbimeve, dy kategoritë kryesore të shërbimeve, gjegjësisht shërbimet e transportit dhe të udhëtimit shënuan rritje prej 55.6 përqind përkatësisht 9.0 përqind.

Bilanci më i ulët i të ardhurave parësore i atribuohet nivelit më të lartë të pagesave që kanë bërë ndërmarrjet e huaja direkte në Kosovë ndaj investitorëve direkt, kryesisht në formë të dividendës. Të ardhurat e realizuara nga investitorët direkt, deri në nëntor të vitit 2015 kanë arritur në 102.7 milionë euro nga 65.7 milionë euro sa ishin në periudhën e njëjtë të vitit 2014. Kategoria më e madhe në kuadër të të hyrave të llogarisë së të ardhurave parësore mbeten të hyrat nga kompensimi i punonjësve, gjegjësisht të hyrat nga të ardhurat e punonjësve

kosovarë jashtë vendit.<sup>6</sup> Deri në nëntor të vitit 2015, të hyrat nga kompensimi i punonjësve shënuan rritje prej 3.4 përqind, duke arritur në 193.0 milionë euro.

Figura 11. Remitencat, në milionë euro



Burimi: BQK (2016)


Bilanci më i ulët i të ardhurave dytësore i atribuohet nivelit më të ulët donacioneve dhe granteve të ndryshme por edhe reduktimit të shpenzimeve nga institucionet e ndryshme ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë. Në anën tjetër, remitencat e pranuar në Kosovë, që njëherësh paraqesin edhe kategorinë më të madhe në kuadër të llogarisë së të ardhurave dytësore, deri në nëntor të vitit 2015 arritën vlerën prej 682.7 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 9.0 përqind (figura 11). Remitencat që pranohen në Kosovë vijnë kryesisht nga Gjermania dhe Zvicra, vende këto nga të cilat dërgohen 36.0 përqind përkatësisht 22.4 përqind të gjithsej remitencave të pranuar në Kosovë. Një pjesë e konsiderueshme e remitencave në vitin 2015 është pranuar edhe nga SHBA-të, gjegjësisht 7.9 përqind e gjithsej remitencave të pranuar në Kosovë.

<sup>6</sup> Kompensimi i punonjësve përfshinë pagat, mëditjet dhe beneficionet e tjera të paguara për punëtorët jorezident në vend, apo të pranuar nga punëtorët rezident jashtë vendit. Në këtë kontekst, përfshinë punëtorët sezonal apo punëtorët tjerë afatshkurtër (më pak se një vit) dhe punëtorët kufitar të cilët qendrën e interesit ekonomik e kanë në ekonominë e tyre.

<sup>5</sup> Të dhënat e fundit në dispozicion për tregtinë e shërbimeve janë deri në nëntor 2015.

Bilanci i investimeve të huaja direkte deri në nëntor të vitit 2015 arriti në 289.7 milionë euro, që paraqet një rritje mjaft të madhe krahasuar me vlerën prej 135.6 milionë euro në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Investimet e Huaja Direkte (IHD) në Kosovë, deri në nëntor të vitit 2015, arritën vlerën prej 316.3 milionë euro (159.9 milionë euro në periudhën e njëjtë të vitit 2014). Në kuadër të strukturës së IHD-ve, me rritje të vlerës u karakterizuan të dy format e IHD-ve, përfshirë kapitalin e fondin e investimeve në aksione, si dhe investimet në instrumentet e borxhit. Kapitali dhe fondi i investimeve në aksione, që përbën rreth 71.0 përqind të gjithsej IHD-ve, shënoi vlerën prej 224.5 milionë euro apo 82.2 përqind më shumë se sa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Normë më të larët të rritjes (150.7 përqind) kanë shënuar edhe IHD-të në formë të instrumenteve të borxhit të cilat arritën në 91.8 milionë euro deri në nëntor 2014 (figura 12).

Figura 12. Struktura e investimeve të huaja direkte sipas komponenteve, në milionë euro



Burimi: BQK (2016)


Sektorët që përfituan më shumë nga rritja e IHD-ve ishin sektori i patundshmërive që arriti vlerën prej 170.7 milionë euro apo 31.6 përqind më shumë

krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2014, pastaj sektori i shërbimeve financiare që shënoi vlerën prej 54.0 milionë euro apo 17.1 përqind më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, sektori i ndërtimit i cili arriti vlerën prej 53.7 milionë euro (vetëm 3.0 milionë euro deri në shtator 2014), etj.

## Sistemi Financiar

Në dhjetor 2015, vlera e gjithsej asetëve të sistemit financiar të Kosovës arriti në 4.91 miliardë euro, që përkon me një rritje vjetore prej 8.1 përqind (figura 13).

Figura 13. Asetet e sistemit financiar, në përqindje



Burimi: BQK (2016)

Sektori bankar dhe sektori pensional vazhdojnë ta kenë kontributin kryesor në zgjerimin e aktivitetit të sistemit financiar në vend.


## Sektori Bankar

### Asetet

Sektori bankar në dhjetor 2015 zgjeroi vlerën e asetëve në 3.39 miliardë euro, që përkon me një rritje vjetore prej 6.3 përqind (4.1 përqind në dhjetor 2014)

(figura 14). Kontributin më të lartë në rritjen e aseteve të sektorit bankar e dha zgjerimi i portfolios së kredive që vazhdon të jetë kategoria dominuese në strukturën e aseteve të sektorit bankar. Përshpejtimi i rritjes së aktivitetit të sektorit bankar reflekton edhe ecurinë e qëndrueshme të depozitave, të cilat po ashtu shënuan përshpejtim të ritmit të rritjes.

Figura 14. Asetet e sektorit bankar, në milionë euro



Burimi: BQK (2016)

Në kuadër të aseteve të sektorit bankar, rritjen më të theksuar vjetore prej 23.4 përqind e shënoi kategoria e letrave me vlerë (8.3 përqind në dhjetor 2014). Rrjedhimisht, pjesëmarrja e kategorisë së letrave në gjithsej asetet e sektorit bankar arriti në 14.0 përqind, nga 12.0 përqind sa ishte në dhjetor 2014. Zgjerimi i portfolios së letrave me vlerë gjatë vitit 2015 i atribuohet kryesisht rritjes së investimeve në letra me vlerë të qeverive të huaja, për dallim nga viti paraprak kur kontributin kryesor në rritje e kishin investimet në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës. Në dhjetor 2015, investimet në letra me vlerë të qeverive të huaja u karakterizuan me rritje prej 29.4 përqind krahasuar me rënien prej 25.0 përqind të shënuar në dhjetor 2014. Ndërsa, investimet në letra

me vlerë të Qeverisë së Kosovës në dhjetor 2015 shënuan rritje vjetore prej 17.4 përqind, e cila paraqet rritje më të ngadalshme krahasuar me rritjen vjetore prej 92.6 përqind të shënuar një vit më parë. Këto zhvillime mund të jenë efekt i ofertës më të ulët të Qeverisë së Kosovës për emetimin e letrave me vlerë krahasuar me vitin paraprak.


Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK po ashtu shënoi rritje të theksuar gjatë vitit 2015. Në dhjetor 2015, paraja e gatshme u karakterizua me rritje vjetore prej 9.9 përqind krahasuar me rënien prej 3.5 përqind të shënuar në dhjetor 2014. Rritja e kësaj kategorie reflekton rritjen e depozitave në sektorin bankar dhe po ashtu normat e ulëta të interesit, madje edhe negative, në tregjet ndërkombëtare të cilat kanë kufizuar mundësitë e bankave komerciale për investime në këto tregje. Këto zhvillime ndikuan edhe në zvogëlimin e bilancit me bankat komerciale, që përfshinë depozitat dhe linjat kreditore në bankat jashtë vendit. Kjo kategori regjistroi rënie vjetore prej 19.1 në dhjetor 2015 përqind, krahasuar me rritjen prej 15.0 përqind të shënuar në dhjetor 2014.

### Kreditë

Kreditë e sektorit bankar vazhduan të karakterizohen me rritje të përshpejtuar që nga viti paraprak. Në dhjetor 2015, vlera e gjithsej kredive arriti në 2.02 miliardë euro, që paraqet rritje vjetore prej 7.3 përqind (4.2 përqind në dhjetor 2014) (figura 15). Rritja e kreditimit gjatë vitit 2015 kryesisht i atribuohet lehtësimit të standardeve dhe kushteve të kreditimit nga ana e bankave, të realizuar përmes uljes së normave të interesit, zgjerimit të shumës së

kredisë si dhe afatit të maturimit në kreditë e ofruara. Kontribut kishte edhe rritja e kërkesës për kredi nga ndërmarrjet dhe ekonomitë familjare.

Figura 15. Ecuria e kredive dhe depozitave




Burimi: BQK (2016)

Në kuadër të gjithsej kredive, rritjen më të lartë vjetore e shënuan kreditë ndaj ekonomive familjare të cilat në dhjetor 2015 shënuan rritje prej 9.7 përqind (10.2 përqind në dhjetor 2014). Rritja e kreditimit të ekonomive familjare i atribuohet kryesisht rritjes prej 27.7 përqind të kredive të reja hipotekare dhe rritjes prej 55.8 përqind të kredive të reja me kushte favorizuese, krahas rënies prej 2.8 përqind të kredive të reja konsumuese. Rritja e kreditimit hipotekar ndër tjerash reflekton edhe rënien e normës së interesit për 0.9 pikë përqindje krahasuar me rënien për 0.4 pikë përqindje të interesit në kreditë konsumuese.

Megjithatë, kontributin kryesor në rritjen e përsheptuar të gjithsej kreditimit të sektorit e kanë dhënë kreditë ndaj ndërmarrjeve, të cilat edhe kanë peshën kryesore në kuadër të kredive (përbëjnë 65.9 përqind të gjithsej kredive). Këto kredi shënuan rritje vjetore prej 6.1 përqind në dhjetor 2015 (3.2 përqind në dhjetor 2014) (figura 16).


Figura 16. Kreditë e ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare



Burimi: BQK (2016)

Struktura e kreditimit të ndërmarrjeve sipas veprimtarive ekonomike mbetet e kryesuar nga kreditë e destinuar për sektorin e tregtisë (me pjesëmarrje prej 51.2 përqind), pasuar nga ato për prodhimtari (12.3 përqind) dhe ndërtimtari (7.5 përqind). Sektori i bujqësisë vazhdon të ketë pjesëmarrje më të ulët në financimin bankar me pjesëmarrje prej 4.5 përqind, por gjatë kësaj periudhe është karakterizuar me rritje të përsheptuar (figura 17).

Figura 17. Kreditë sipas sektorëve ekonomik, në përqindje



Burimi: BQK (2016)

Sa i përket tendencave të fundit të kreditimit të sektorëve ekonomik, deri në dhjetor 2015, kreditimi i

të gjithë sektorëve shënoi rritje, duke përjashtuar sektorin e ndërtimitarisë i cili vazhdon të karakterizohet me trend rënës që nga viti 2013. Vlenë të theksohet që sektorët të cilët përgjithësisht kanë pjesëmarrje më të ulët në kreditimin bankar, siç janë sektori i bujqësisë dhe i shërbimeve financiare, gjatë vitit 2015 shënuan rritje më të theksuar, gjë që paraqet zhvillim të rëndësishëm për mbështetjen e zhvillimit ekonomik në vend.


Rritjen më të theksuar vjetore prej 55.1 përqind në kuadër të kredive ndaj ndërmarrjeve e regjistroi kreditimi për sektorin e shërbimeve financiare që paraqet përmirësim të theksuar krahasuar me rënie prej 11.9 përqind të shënuar në dhjetor 2014. Rimëkëmbja, kryesisht i atribuohet rritjes së regjistrimit të ndërmarrjeve të reja me aktivitet financiar dhe sigurime, ku viti 2015 reflekton numrin më të madh të regjistrimeve në këtë sektor në krahasim me të gjitha periudhat paraprake. Më specifikisht, deri në dhjetor 2015, numri i ndërmarrjeve të reja u dyfishua në 95 ndërmarrje krahasuar me vitin paraprak (43 deri në dhjetor 2014).

Normën e dytë më të lartë të rritjes prej 20.3 përqind e regjistroi kreditimi i sektorit të bujqësisë që paraqet një përmirësim të theksuar krahasuar me rritjen prej 8.7 përqind të shënuar në dhjetor 2014. Përmirësimi mund të jetë ndikuar nga dyfishimi i buxhetit të qeverisë për vitin 2015 për programin e subvencioneve dhe granteve në këtë sektor, gjë që u reflektua edhe në rritjen e numrit të bizneseve të reja të regjistruara në këtë sektor. Deri në dhjetor 2015, janë raportuar rreth 40 përqind më shumë biznese të reja në sektorin e bujqësisë krahasuar me periudhën e

njëjtë të vitit të kaluar. Njëkohësisht, edhe norma e interesit në kreditë e reja ndaj sektorit të bujqësisë në dhjetor 2015 shënoi rënie më të theksuar prej 4.3 pikë përqindje krahasuar me sektorët tjerë. Si rrjedhojë e zvogëlimit të theksuar, në dhjetor 2015, norma e interesit në kreditë për ndërmarrjet bujqësore ishte më e ulëta nga të gjithë sektorët e tjerë për dallim nga vitet paraprak kur normat e interesit për ndërmarrjet bujqësore ishin më të lartat.

Kreditimi i sektorit të tregtisë në dhjetor 2015 shënoi rritje prej 1.3 përqind që paraqet ngadalësim krahasuar me rritjen prej 5.3 përqind të shënuar në dhjetor 2014. Ritmi më i ngadalësuar i rritjes, mes tjerash, reflekton ecurinë e ngjashme të aktivitetit tregtar të Kosovës me vendet tjera, ku vërehet performancë më e dobët si te eksportet ashtu edhe te importet.

Figura18. Ndryshimi vjetor i kredive sipas sektorëve ekonomik




Burimi: BQK (2016)

Rritje të kredive të pranuar regjistroi edhe sektori i industrisë, që megjithëse me ritëm më të ngadalësuar të rritjes krahasuar me vitin paraprak, ishte ndër sektorët me rritjen më të lartë të kreditimit gjatë vitit 2015. Norma vjetore e rritjes së kredive për këtë sektor në dhjetor 2015 ishte 7.3 përqind (16.2 përqind në dhjetor 2014) (figura 18).

Në anën tjetër, përkundër rënies së normave të interesit dhe lehtësimit të standardeve të kreditimit nga ana e bankave, kreditimi i sektorit të ndërtimtarisë vazhdon të zvogëlohet. Në dhjetor 2015, kreditë për sektorin e ndërtimtarisë regjistruan rënie vjetore prej 7.0 përqind (rënie prej 9.9 përqind në dhjetor 2014).

Figura 19. Kreditë sipas afatit të maturimit, në përqindje



Burimi: BQK (2016)

Sipas afatit të maturimit, struktura e gjithsej kredive vazhdon të dominohet nga kreditë afatmesme, gjegjësisht kreditë me afat maturimi 'mbi 2 deri në 5 vite' (figura 19). Megjithatë, krahasuar me periudhat e kaluara, vërehet një tendencë e zhvendosjes drejt kreditimit afatgjatë. Në dhjetor 2015, kreditë afatshkurtra 'deri në 1 vit' shënuan rënie të pjesëmarrjes në strukturë ndërsa, kategoria e kredive afatgjata 'mbi 5 vite' vazhdoi të rritet me ritëm më të shpejtë.

*Aktiviteti kreditues i sektorit bankar gjatë vitit 2015 u karakterizua me ritëm të përshpejtuar të rritjes. Rritje më të theksuar shënuan kreditë për sektorët që kanë pjesëmarrje më të ulët në kreditimin bankar, si sektori i bujqësisë, prodhimit dhe shërbimeve financiare, gjë që tregon për rritje të mbështetjes financiare për këta*

*sektorë shumë të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të vendit.*

### Detyrimet

Struktura e detyrimeve të sektorit bankar dominohet nga depozitat, që përbëjnë rreth 79.8 përqind të gjithsej detyrimeve, duke përfaqësuar kështu burimin kryesor të financimit të aktivitetit të sektorit bankar. Mbështetja e lartë në depozitat e mbledhura brenda vendit, dhe veçanërisht në depozita të ekonomive familjare të cilat konsiderohen burim më i qëndrueshëm i financimit, eviton ekspozimin e sektorit ndaj lëvizjeve në tregjet e jashtme financiare.

Kategoria e bilancit me bankat tjera në dhjetor 2015 arriti në 43.4 milionë euro që përkon me një rritje vjetore prej 37.2 përqind. Kategoria e huazimeve tjera (përfshirë çertifikatat e depozitave) regjistroi rritje prej 24.7 përqind në dhjetor 2015 dhe arriti vlerën prej 17.6 milionë euro.

Me rritje të theksuar u karakterizuan edhe mjetet vetanake të sektorit bankar, që janë kategoria e dytë për nga pjesëmarrja me 11.6 përqind në gjithsej detyrimet e sektorit. Në dhjetor 2015, mjetet vetanake shënuan rritje vjetore prej 21.9 përqind (16.3 përqind në dhjetor 2014). Rritja ishte kryesisht si rezultat i rritjes rekorde të profitit të realizuar nga sektori bankar gjatë vitit 2015.


### Depozitat

Vlera e gjithsej depozitave në sektorin bankar të Kosovës arriti në 2.70 miliardë euro në dhjetor 2015,



që paraqet rritje vjetore prej 6.5 përqind (3.6 përqind në dhjetor 2014) (figura 20). Kjo normë e rritjes paraqet rimëkëmbje të ecurisë së depozitave krahasuar me vitet paraprake, kur ritmi i rritjes së depozitave ishte ngadalësuar. Rritjes së depozitave, ndër tjerash, ka mund t'i ketë kontribuar edhe ndërprerja e trendit rënës së normave të interesit në depozita që nga tremujori i dytë i vitit 2015.

Figura 20. Depozitat, në milionë euro




Burimi: BQK (2016)

Struktura e gjithsej depozitave të sektorit dominohet nga depozitat e ekonomive familjare, të cilat përbëjnë 72.7 përqind të gjithsej depozitave. Depozitat e ndërmarrjeve me pjesëmarrje prej 21.6 përqind janë kategoria e dytë për nga pesha në strukturë. Ndërsa, pjesa tjetër prej 5.7 përqind përbëhet nga depozitat e tjera (depozitat e jorezidentëve, organizatave jo-qeveritare, qeveritë qendrore dhe lokale) (figura 21).

Sa i përket ecurisë së depozitave, ritmi i rritjes së gjithsej depozitave diktohet kryesisht nga depozitat e ekonomive familjare si kategoria dominuese. Në dhjetor 2015, depozitat e ekonomive familjare regjistruan normë vjetore të rritjes prej 6.3 përqind (4.1 përqind në dhjetor 2014).

Figura 21. Struktura e depozitave, në përqindje




Burimi: BQK (2016)

Megjithatë në ecurinë e gjithsej depozitave kontribut mund të kenë dhënë edhe depozitat e ndërmarrjeve që në dhjetor 2015 shënuan rritje të theksuar vjetore prej 4.2 përqind (nga rritja prej 0.7 përqind në dhjetor 2014). Depozitat tjera (depozitat e jo-rezidentëve, organizatave jo-qeveritare, qeveritë qendrore dhe lokale etj.) gjithashtu u karakterizuan me rritje vjetore të theksuar prej 19.0 përqind në dhjetor 2015 (9.4 përqind në dhjetor 2014), kryesisht si rrjedhojë e rritjes së theksuar të depozitave të jorezidentëve.

Struktura e depozitave sipas afatit të maturimit ka pësuar ndryshime të theksuara krahasuar me vitet paraprake. Depozitat e afatizuara vazhdojnë të ngushtojnë pjesëmarrjen në strukturë me një ritëm të theksuar që nga viti 2013, që mund të jetë si rezultat i rënies së normave e interesit gjatë asaj periudhe. Në dhjetor 2015, depozitat e afatizuara ngushtuan pjesëmarrjen në 24.7 përqind të gjithsej depozitave (nga 31.7 përqind në dhjetor 2014), përderisa depozitat e transferueshme zgjeruan pjesëmarrjen në 54.7 përqind (47.2 përqind në dhjetor 2014). Kategoria e mbetur, ajo e depozitave të kursimit, në dhjetor 2015 lehtësisht ka zvogëluar pjesëmarrjen në

20.6 përqind të gjithsej depozitave (nga 21.1 përqind në dhjetor 2014) (figura 22).


Figura 22. Struktura depozitave sipas maturimit, në përqindje



Burimi: BQK (2016)

Edhe pse gjithsej depozitat e afatizuara janë karakterizuar me rënie, në kuadër të strukturës së tyre vërehet një zhvendosje e theksuar drejt afateve më të gjata të maturimit. Depozitat me afat të gjatë maturimi ‘mbi 2 vite’ dhe ato afatmesme ‘mbi 1 deri në 2 vite’ kanë rritur pjesëmarrjen në strukturë, ndërsa depozitat afatshkurta ‘deri 1 vit’ kanë zvogëluar pjesëmarrjen në strukturën e gjithsej depozitave të afatizuara (figura 23).

Figura 23. Depozitat e afatizuara, në përqindje



Burimi: BQK (2016)


Këto lëvizje janë konform lëvizjeve të normave të interesit, të cilat mbesin më të larta në depozitat me maturitet më të gjatë.

Gjatë vitit 2015, depozitat e sektorit bankar përshpejtuan ritmin e rritjes, duke ndërprerë kështu trendin e ngadalësuar të viteve të fundit. Trendi i ngushtimit të depozitave të afatizuara dhe zgjerimit të depozitave të transferueshme vazhdoi edhe gjatë kësaj periudhe, duke reflektuar kryesisht nivelin e ulët të normave të interesit në depozita.

### Normat e Interesit

Normat e interesit në kredi gjatë vitit 2015 shënuan rënie më të theksuar. Në dhjetor 2015, norma mesatare e interesit në kredi u zvogëluar në 7.7 përqind nga 9.3 përqind sa ishte në dhjetor 2014. Në anën tjetër, normat e interesit në depozita shënuan rritje të lehtë, për dallim nga viti 2014 kur kishin shënuar rënie të theksuar. Në dhjetor 2015, norma mesatare e interesit në depozita arriti në 1.2 përqind nga 1.1 përqind sa ishte në dhjetor 2014. Dallimi në mes të normës së interesit në kredi dhe normës së interesit në depozita në dhjetor 2015 u zvogëluar në 6.5 përqind nga 8.2 përqind sa ishte në dhjetor 2014 (figura 24).

Figura 24. Norma mesatare e interesit në kredi dhe depozita




Burimi: BQK (2016)

**Normat e interesit në kredi**

Gjatë vitit 2015, norma e interesit në kredi shënoi rënie si në kreditë ndaj ndërmarrjeve ashtu edhe në kreditë ndaj ekonomive familjare. Megjithatë, që nga tremujori i dytë i vitit 2015, rënia ishte më e shprehur në kreditë ndaj ndërmarrjeve, krahasuar me ato ndaj ekonomive familjare. Në dhjetor 2015, norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve u zvogëlua në 7.4 përqind nga 9.6 përqind sa ishte në dhjetor 2014. Në kuadër të kredive ndaj ndërmarrjeve, kreditë investuese vazhdojnë të karakterizohen me normat më të ulëta të interesit me një masatare prej 7.2 përqind në dhjetor 2015, përderisa mesatarja e interesit për kreditë jo-investuese ishte 7.8 përqind në dhjetor 2015 (figura 25).

Figura 25. Norma mesatare e interesit në kreditë e ndërmarrjeve




Burimi: BQK (2016)

Niveli më i ulët i normave të interesit për kreditë investuese mund të ketë nxitur rritjen më të shpejtë të kredive të reja të kësaj kategorie, të cilat shënuan rritje vjetore prej 20.8 përqind në vitin 2015, krahasuar me kreditë e reja jo-investuese, të cilat shënuan rritje vjetore prej 7.1 përqind në vitin 2015.

Me rënie të normave të interesit u karakterizuan edhe kategoritë tjera si mbitërheqjet dhe linjat e ndryshme kreditore ndaj ndërmarrjeve. Norma e interesit për linjat e ndryshme kreditore ndaj ndërmarrjeve shënoi rënie më të theksuar, duke arritur në 8.5 përqind nga 11.8 përqind sa ishin në dhjetor 2014. Ndërsa, norma mesatare e interesit në mbitërheqjet e ndërmarrjeve u zvogëlua në 7.1 përqind nga 9.4 përqind në dhjetor 2014.

Sipas afatit të maturimit të kredive, rënia më e theksuar e normës së interesit prej 2.8 pikë përqindje u regjistrua te kreditë me afat të mesëm maturimi (figura 26). Në dhjetor 2015, norma më e ulët e interesit prej 6.9 përqind u regjistrua te kreditë me afat maturimi ‘mbi 5 deri në 10 vite’ gjë që edhe u reflektua në rritjen e lartë vjetore prej 62.6 përqind të kredive të reja në këtë kategori gjatë së njëjtës periudhë. Norma më e lartë e interesit prej 8.0 përqind u regjistrua te kreditë me afat maturimi ‘deri 1 vit’.

Figura 26. Norma mesatare e interesit në kreditë e ndërmarrjeve, sipas maturimit




Burimi: BQK (2016)

Sipas veprimtarive ekonomike, me rënie të normave të interesit u karakterizuan kreditë për të gjithë sektorët e ekonomisë, por rënia më e theksuar u

shënuar te kreditë ndaj sektorit të bujqësisë dhe të shërbimeve. Në dhjetor 2015, norma mesatare e interesit në kreditë për sektorin e bujqësisë u zvogëlua në 7.1 përqind nga 11.3 përqind sa ishte në dhjetor 2014 (figura 27). Zvogëlimi i normës së interesit për këto kredi vlerësohet të ketë qenë kontribues i rëndësishëm i përshpejtimit të rritjes së kredive për sektorin e bujqësisë, që në vitin 2015 ishte sektori me rritjen më të lartë të kreditimit. Norma e interesit në kreditë ndaj sektorit të shërbimeve (përfshirë edhe tregtinë që përfaqëson 70.2 përqind të gjithsej stokut të kredive të shërbimeve) u zvogëlua në 7.4 përqind (10.0 përqind në dhjetor 2014), gjë që u reflektua gjithashtu në rritje të përshpejtuar të kreditimit për shërbimet tjera (përfshirë shërbimet financiare në krahasim me vitin paraprak, përderisa për tregti kreditimi është ngadalësuar. Rënie shënuar edhe normat e interesit për kreditë ndaj sektorit të industrisë, të cilat u zvogëluan në 7.4 përqind në dhjetor 2015 (8.9 përqind në dhjetor 2014).

Figura 27. Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomik




Burimi: BQK (2016)

Sa i përket kredive për ekonomitë familjare, në dhjetor 2015, norma mesatare e interesit u zvogëlua në 8.4 përqind nga 8.9 përqind sa ishte në dhjetor

2014. Rënia më e theksuar u regjistrua te kreditë hipotekare, kur norma mesatare e interesit u zvogëlua në 7.0 përqind nga 7.9 përqind në dhjetor 2014. Ndërsa, norma mesatare e interesit për kreditë konsumuese u zvogëlua në 8.7 përqind nga 9.1 përqind sa ishte në dhjetor 2014 (figura 28).

Figura 28. Norma mesatare e interesit në kreditë e ekonomive familjare



Burimi: BQK (2016)


Në kuadër të kredive hipotekare, kreditë me maturim më afatgjatë kishin norma më të ulëta të interesit krahasuar me ato afatshkurtra. Norma më e ulët e interesit prej 5.9 përqind u regjistrua te kreditë hipotekare me afat maturimi ‘mbi 10 vite’, ndërsa më e larta prej 7.4 përqind u regjistrua te kreditë me afat maturimi ‘mbi 2 vite deri në 5 vite’. Në kuadër të kredive hipotekare, kreditë me afat maturimi ‘mbi 10 vite’ shënuar rënie më të theksuar vjetore të normës mesatare të interesit prej 1.9 pikë përqindje.

### Normat e interesit në depozita

Trendi rritës i normës së interesit në gjithsej depozitat që nga tremujori i dytë i vitit 2015 kryesisht reflekton rritjen e normës së interesit në depozitat e ekonomive familjare, të cilat dominojnë

strukturën e depozitave të sektorit bankar. Ndërsa, norma e interesit në depozitat e ndërmarrjeve ndërpreu trendin rënës vetëm në tremujorin e katërt të vitit 2015. Megjithatë, vlen të theksohet që gjatë pjesës më të madhe të vitit 2015 (përfshirë tremujorin e tretë), norma e interesit në depozitat e ndërmarrjeve ishte më të larta krahasuar me interesin për depozitat e ekonomive familjare (figura 29).

Figura 29. Norma mesatare e interesit në depozita




Burimi: BQK (2016)

Në dhjetor 2015, norma e interesit në depozitat e ndërmarrjeve u zvogëluar në 1.5 përqind në dhjetor 2015 nga 1.6 përqind sa ishin në dhjetor 2014 (figura 29). Norma e interesit në depozitat e afatizuara u zvogëluar në 1.5 përqind në dhjetor 2015 (1.6 në dhjetor 2014), ndërsa për depozitat kursimeve norma e interesit u zvogëluar në 0.1 përqind në dhjetor 2015 (0.7 përqind në dhjetor 2014) figura 30).

Sipas afatit të maturimit, normat më të ulëta të interesit ishin të pranishme në depozitat me afat maturimi ‘mbi 1 muaj deri në 3 muaj’ (0.7 përqind), kurse normat më të larta u hasën në depozitat me afat maturimi ‘mbi 2 vite’ (3.2 përqind).

Figura 30. Norma mesatare e interesit në depozitat për ndërmarrje, sipas kategorive




Burimi: BQK (2016)

Norma mesatare e interesit në depozitat e ekonomive familjare në dhjetor 2015 arriti në 1.1 përqind nga 0.9 përqind sa ishte në dhjetor 2014. Trendi pozitiv i normës mesatare të interesit në depozita kryesisht reflekton rritjen e lehtë të normës së interesit në depozitat e afatizuara. Në dhjetor 2015, norma e interesit në depozitat e afatizuara arriti në 1.1 përqind nga 0.9 përqind sa ishte në dhjetor 2014 (figura 30).

Në kuadër të depozitave të afatizuara, norma më e ulët e interesit prej 0.2 përqind u regjistrua në depozitat me afat maturimi ‘deri në 1 muaj’, përderisa ajo më e larta prej 2.2 përqind u regjistrua në depozitat me afat maturimi ‘mbi 2 vite’. Ndërsa, rritjen më të theksuar vjetore prej 0.6 pikë përqindje e shënoi norma e interesit në depozitat me afat maturimi ‘mbi 1 vit deri në 2 vite’.

Figura 31. Norma mesatare e interesit në depozitat për ekonomitë familjare, sipas kategorive



Burimi: BQK (2016)

Në anën tjetër norma e interesit në depozitat e kursimeve të ekonomive familjare në dhjetor 2015 u zvogëluar në 0.3 përqind nga 0.6 përqind sa ishte në dhjetor 2014. Normat e ulëta të interesit në depozitat e afatizuara dhe të kursimeve në dy vitet e fundit kontribuan në zhvendosjen e ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve drejt depozitave të transferueshme, të cilat kanë arritur të bëhen kategoria më peshën më të madhe në gjithsej depozitat.

### Performanca e sektorit bankar

Profiti i realizuar nga sektori bankar në vitin 2015 arriti vlerën prej 94.7 milionë euro (60.5 milionë euro në vitin 2014), që paraqet shumë më të lartë të profitit të regjistruar që nga fillimi i funksionimit të këtij sektori. Përmirësimi i performancës financiare të sektorit bankar erdhi si rrjedhojë e zvogëlimit të theksuar të shpenzimeve, përderisa edhe të hyrat e sektorit bankar shënuan rënie.

Në dhjetor 2015, të hyrat e sektorit bankar arritën vlerën 238.2 milionë euro, që paraqet një rënie vjetore prej 2.9 përqind. Kontributin kryesor në rënien e

gjithsej të hyrave kishin të hyrat nga interesi që në dhjetor 2015 shënuan rënie vjetore prej 5.7 përqind. Rënia e të hyrave nga interesi në masë të madhe i atribuohet zvogëlimit të të hyrave nga interesi në kredi kryesisht si rrjedhojë e rënies së normave të interesit, pavarësisht përshpejtimit të aktivitetit kreditor gjatë kësaj periudhe. Të hyrat nga jo-interesi në dhjetor 2015 shënuan rritje vjetore prej 7.2 përqind kryesisht si rezultat i rritjes së të ardhurave nga tarifat dhe komisionet që, ndër tjerash, reflekton shtrenjtimin e shërbimeve të ofruara në degët bankare.


Vlera e gjithsej shpenzimeve të sektorit bankar në dhjetor 2015 arriti në 143.5 milionë euro, që paraqet një rënie vjetore prej 22.3 përqind. Zvogëlimi i gjithsej shpenzimeve në masë të madhe ishte rezultat i reduktimit të shpenzimeve të jo-interesit, që shënuan rënie vjetore prej 88.6 përqind. Në kuadër të tyre, rënie më të theksuar shënuan shpenzimet për provizione në kredi të cilat regjistruan rënie vjetore prej 141.1 përqind, kryesisht si rezultat i zvogëlimit të kredive joperformuese.

Gjithashtu, në rënien e gjithsej shpenzimeve ndikim të konsiderueshëm kishin edhe shpenzimet e interesit që shënuan rënie vjetore prej 48.7 përqind, kryesisht si rezultat i rënies për 54.0 përqind të shpenzimeve të interesit në depozita. Pavarësisht rritjes së lehtë të normave të interesit në depozita gjatë pjesës më të madhe të vitit 2015, ulja e theksuar e tyre gjatë dy viteve të fundit u reflektua në rënien e shpenzimeve në vitin 2015.

Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative, që përfaqësojnë pjesën më të madhe të gjithsej

shpenzimeve, ishin e vetmja kategori e cila shënoi rritje, duke regjistruar një normë vjetore të rritjes prej 5.2 përqind në vitin 2015. Kjo rritje kryesisht i atribuohet shpenzimeve tjera nga jo interesi (marketingut, shpenzimeve ligjore, shpenzimeve të pashpalosura etj.), ndërsa në një shkallë më të ulët i atribuohet edhe rritjes së shpenzimeve të personelit.


Figura 32. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit bankar



Burimi: BQK (2016)

Raporti i shpenzimeve ndaj të hyrave të sektorit ka shënuar përmirësim të dukshëm krahasuar me vitin e kaluar si rezultat i rënies së theksuar të shpenzimeve. Në dhjetor 2015, ky indikator u përmirësua në 60.3 përqind, krahasuar me 75.3 përqind sa ishte në vitin paraprak (figura 32).

Figura 33. Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar




Burimi: BQK (2016)

Profiti i realizuar në vitin 2015 ka ndikuar në përmirësimin e mëtutjeshëm të indikatorëve të profitabilitetit, siç janë Kthimi në Mesataren e Aseteve (ROAA) dhe Kthimi në Mesataren e Kapitalit (ROAE). ROAA arriti në 2.9 përqind, nga 2.0 përqind sa ishte në 2014, përderisa ROAE arriti në 26.4 përqind, nga 20.3 përqind sa ishte në 2014 (figura 33).

### Treguesit e shëndetit financiar

Sektori bankar gjatë vitit 2015 regjistroi rënie të kredive joperformuese dhe, njëkohësisht, shënoi përmirësim të mbulueshmërisë së tyre me provizione (figura 34).

Figura 34. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore




Burimi: BQK (2016)

Në dhjetor 2015, pjesëmarrja e kredive joperformuese në gjithsej kreditë e sektorit u zvogëlua në 6.2 përqind (8.3 përqind në dhjetor 2014) kryesisht si rezultat i rënies vjetore prej 20.5 përqind të vlerës së kredive jo performuese, në njërën anë, si dhe përsheptimit të rritjes së gjithsej kredive, në anën tjetër (figura 35). Mbulueshmëria me provizione e kredive joperformuese në dhjetor 2015 u përmirësua në 115.1 përqind, krahasuar me 114.4 përqind në dhjetor 2014.

Sektori bankar vazhdon të ketë nivel të kënaqshëm të kapitalizimit, ku Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit (CAR) arriti në 19.0 përqind në dhjetor 2015 nga 17.8 përqind sa ishte në dhjetor 2014. Përforcimi i kapitalizimit të sektorit bankar kryesisht i atribuohet rritjes së profitit të realizuar nga bankat. Sektori bankar vazhdon gjithashtu të ketë pozicion të kënaqshëm të likuiditetit. Në dhjetor 2015, raporti i kredive ndaj depozitave ishte 74.8 përqind, kurse raporti i mjeteve likuide ndaj gjithsej detyrimeve afatshkurtra qëndroi në 44.9 përqind në dhjetor 2015.

Figura 35. Ndryshimi vjetor i gjithsej kredive dhe kredive joperformuese




Burimi: BQK (2016)

*Sektori bankar i Kosovës shënoi nivel të lartë të profitit në vitin 2015 si rezultat i zvogëlimit të shpenzimeve. Cilësia e portofolit kreditor shënoi përmirësim të mëtutjeshëm, duke arritur normën më të ulët të kredive joperformuese të regjistruar në vitet e fundit. Sektori bankar vazhdon të ketë nivel të lartë të kapitalizimit dhe pozicion të fuqishëm të likuiditetit.*

## Sektori pensional

Vlera e aseteve të sektorit pensional në dhjetor 2015 arriti në 1.24 miliard euro, duke shënuar rritje vjetore prej 13.1 përqind (figura 36). Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK) përfaqëson pjesën më të madhe të aseteve të sektorit (99.4 përqind), ndërsa pjesa e mbetur (0.6 përqind) menaxhohet nga Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve (FSKP).

Figura 36. Asetet e sektorit pensional, në milionë euro



Burimi: BQK (2016)

Në dhjetor 2015, vlera e gjithsej aseteve të FKPK-së arriti në 1.23 miliardë euro, që përkon me rritje vjetore prej 13.1 përqind, rritje kjo më e ngadalshme krahasuar me rritjen vjetore prej 19.1 përqind të regjistruar në dhjetor 2014. Ngadalësimi i rritjes së aseteve të FKPK-së i atribuohet ecurisë së arkëtimeve të reja dhe performancës së kthimit në investime. Arkëtimet e reja deri në dhjetor 2015 arritën në 137.5 milionë euro nga rreth 508.0 mijë kontribues që përkon me një rritje vjetore prej 6.8 përqind. Rrjedhimisht, kemi një ritëm më të ngadalshëm të rritjes krahasuar me dhjetor 2014 kur u arkëtuan 128.7 milionë euro nga rreth 476.6 mijë që paraqiste një rritje vjetore prej 8.0 përqind.



Me rritje të ngadalësuar u karakterizua edhe kthimi në investime, ku deri në dhjetor 2015 vlera e kthimit në investime ishte 29.6 milion euro (ose 2.3 përqind) krahasuar kthimin prej 66.7 milion euro (ose 6.3 përqind) deri në dhjetor 2014. Kjo ishte si rezultat i kthimit negativ nga investimet në sektorin e jashtëm gjatë tremujorit të dytë dhe të tretë të vitit 2015. Kthimi më i ulët në investime gjatë vitit 2015 u ndikua nga lëvizjet e mëdha në tregjet financiare globale gjatë tremujorit të dytë dhe të tretë të vitit 2015 si rezultat i zhvillimeve ekonomike dhe politike në disa vende të eurozonës dhe parashikimet për dobësim të ekonomisë kineze, që u reflektuan edhe në ekonominë e SHBA-ve, dhe rrjedhimisht ndikuan në investimet e jashtme të FKPK-së. Në ditën e fundit të muajit dhjetor 2015, çmimi i aksionit arriti në 1.317 euro (1.288 euro në dhjetor 2014).

Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve shënoi rritje vjetore të aseteve dhe kthim pozitiv nga investimet. Në dhjetor 2015, vlera e gjithsej aseteve të FSKP-së arriti në 6.0 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 3.0 përqind, që po ashtu është më e ulët se sa rritja prej 9.2 përqind në dhjetor 2014. Ngadalësimi i rritjes së vlerës së aseteve të FSKP-së ishte pasojë e rritjes më të ngadalshme të arkëtimeve të reja dhe po ashtu rritjes më të ulët të kthimit nga investimet. Vlera e kontributeve të arkëtuara deri në dhjetor 2015 arriti në 461.4 mijë euro nga 4,025 kontribues, që përkon me një rritje vjetore prej 1.8 përqind. Kjo paraqet një ngadalsim të lehtë krahasuar me dhjetor 2014 kur u arkëtuan 453.2 mijë euro (2.1 përqind rritje vjetore) nga 393.0 mijë kontribues.

Kthimi bruto nga investimet e FSKP-së deri në dhjetor 2015 arriti në 158.7 mijë euro, që është


dukshëm më i ulët krahasuar me kthimin prej 371.9 mijë euro të regjistruar në vitin 2014. Ngjashëm me FKPK-në, performanca e investimeve të FSKP-së u ndikua nga lëvizjet në tregjet financiare globale gjatë tremujorit të dytë dhe të tretë të vitit 2015. Në ditën e fundit të dhjetorit 2015, çmimi i aksionit të FSKP-së arriti në 145.30 euro (145.16 euro në dhjetor 2014)<sup>7</sup>.

*Sektori pensional gjatë vitit 2015 shënoi rritje të ngadalësuar të aseteve kryesisht si rezultat i ecurisë së arkëtimit të kontributeve të reja si dhe ngadalësimit të rritjes së kthimit në investime si rrjedhojë e zhvillimeve në tregjet financiare ndërkombëtare..*

## Sektori i sigurimeve

Gjithsej asetet e sektorit të sigurimeve në dhjetor 2015 shënuan rritje vjetore prej 9.1 përqind, duke arritur vlerën 152.7 milionë euro (figura 37).

Figura 37. Asetet e sektorit të sigurimeve, në milionë euro



Burimi: BQK (2016)

Sigurimet jo-jetë përfaqësojnë pjesën më të madhe të sektorit (90.0 përqind të gjithsej aseteve të sektorit), dhe shënuan rritje vjetore prej 9.2 përqind, për dallim nga viti paraprak kur kishin shënuar rritje vjetore prej 5.1 përqind. Rritja e aseteve të sigurimit jo-jetë kryesisht rezultoi nga fillimi i operimit të dy

<sup>7</sup> Vlera bazë e aksionit të FSKP-së është 100 për dallim nga ajo e FKPK-së që është 1.

kompanive të reja në këtë sektor. Ndërsa, sigurimet jetë përfaqësojnë pjesën e mbetur të aseteve të sektorit (10.0 përqind të gjithsej aseteve) dhe në dhjetor 2015 shënuan rritje vjetore prej 7.7 përqind (9.2 përqind në vitin 2014).

### Aktiviteti

Vlera e gjithsej primeve të shkruara në dhjetor 2015 arriti në 80.0 milionë euro që paraqet një rënie vjetore prej 2.6 përqind, për dallim nga viti i kaluar kur primet e shkruara kishin shënuar rritje vjetore prej 3.8 përqind.

Struktura e primeve të shkruara kryesohet nga primet e sigurimit jo-jetë të cilat përfaqësojnë 96.6 përqind të gjithsej primeve të shkruara. Rrjedhimisht edhe ecuria e gjithsej primeve diktohet nga trendi i primeve të sigurimit jo-jetë. Primet e shkruara jo-jetë në dhjetor 2015 arritën vlerën 77.3 milionë euro që përkon me një rënie vjetore prej 3.0 përqind, krahasuar me rritjen vjetore prej 3.4 përqind të regjistruar në dhjetor 2014.


Primet e sigurimit jetë përfaqësojnë vetëm 3.4 përqind të gjithsej primeve të sektorit. Në dhjetor 2015, primet e sigurimit jetë arritën vlerën 2.7 milionë euro që paraqet një rritje vjetore prej 11.1 përqind (16.6 përqind në dhjetor 2014). Rritja e primeve të sigurimit jo-jetë kontribuoi në zbutjen e rënies vjetore të gjithsej primeve të shkruara.

Gjithsej dëmet e paguara nga kompanitë e sigurimeve dhe Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) në dhjetor 2015 arritën vlerën 36.2 milionë euro, duke shënuar një rritje vjetore prej 11.9 përqind, për dallim nga viti i kaluar kur vlera e dëmeve të paguara kishte

shënuar rënie vjetore prej 16.8 përqind. Ndikim të rëndësishëm në rritjen e gjithsej dëmeve të paguara ka pasur rritja e dëmeve të paguara për sigurimet jo-jetë, që shënuan rritje vjetore prej 11.7 përqind, krahasuar me rënien vjetore prej 16.6 përqind në vitin 2014. Po ashtu, rritje kanë shënuar edhe pagesat për dëmet e sigurimit të jetës, të cilat shënuan rritje vjetore prej 38.2 përqind, krahasuar me rënien vjetore prej 5.0 përqind të regjistruar në vitin 2014. Dëmet e paguara nga Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) po ashtu shënuar rritje, duke regjistruar një normë vjetore të rritjes prej 2.2 përqind (-18.2 përqind në dhjetor 2014).

Rritja e dëmeve të paguara dhe zvogëlimi i vlerës së primeve të shkruara rezultoi në rritje të raportit të gjithsej dëmeve të paguara ndaj primeve të shkruara, që, në dhjetor 2015 arriti në 64 % përqind krahasuar me 52 % përqind sa ishte në dhjetor 2014 (figura 38).

Figura 38. Primet e pranuar dhe dëmet e paguara, në milionë euro.




Burimi: BQK (2016)

### Performanca e sektorit të sigurimeve

Në vitin 2015, sektori i sigurimeve regjistroi humbje në vlerë prej 7.7 milionë euro, krahasuar me humbjen prej 2.5 milionë euro në vitin paraprak. Thellimi i

humbjes ishte rrjedhojë e humbjes së shënuar në kuadër të sigurimit jo-jetë, përderisa përforma financiare e sigurimit jetë ishte pozitive. Gjatë vitit 2015, sigurimi jo-jetë shënoi humbje prej 8.1 milionë euro (humbje prej 3.0 milionë në vitin 2014), ndërsa sigurimi jetë regjistroi fitim në vlerë prej 377.9 mijë euro në vitin 2015 (487.5 mijë euro në vitin 2014). Thellimi i humbjes së sektorit ndikoi në përkeqësimin e mëtutjeshëm të indikatorëve të profitabilitetit siç janë Kthimi në Mesataren e Aseteve (ROAA) dhe Kthimi në Mesataren e Kapitalit (ROA). ROAA u përkeqësua në -5.3 përqind (-1.8 përqind në vitin 2014), kurse ROAE në -16.0 përqind (-5.5 përqind në vitin 2014). Sektori i sigurimeve gjithashtu u karakterizua me përkeqësim të nivelit të likuiditetit.

Figura 39. Treguesit e profitabilitetit të sektorit të sigurimeve



Burimi: BQK (2016)

Raporti ndërmjet parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj ndaj rezervave zbriti në 101.1 përqind në 2015 (në dhjetor 2014 ishte 119.3 përqind), përderisa raporti ndërmjet parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj ndaj gjithsej detyrimeve shënoi rënie në 91.9 përqind (në dhjetor 2014 ishte 102.3 përqind).


Sektori i sigurimeve në vitin 2015 shënoi rritje të asetëve, mirëpo vlera e primeve të shkruara u karakterizua me rënie. Në anën tjetër, vlera e dëmeve të paguara shënoi rritje, duke çuar kështu në rritje të raportit ndërmjet dëmeve të paguara dhe primeve të shkruara. Performanca financiare e sektorit të sigurimeve vazhdon të jetë e brishtë, e karakterizuar me thellim të humbjes gjatë vitit 2015.

## Sektori mikrofinanciar

### Asetet

Sektori mikrofinanciar u karakterizua me zgjerim të përsheptuar të aktivitetit, ku vlera e asetëve të sektorit në dhjetor 2015 arriti në 119.7 milionë euro, që përkon me një rritje vjetore prej 6.0 përqind (figura 40).

Figura 40. Asetet e sektorit mikrofinanciar




Burimi: BQK (2016)

Struktura e asetëve të sektorit mikrofinanciar dominohet nga kreditë që përbëjnë 68.8 përqind të gjithsej asetëve të sektorit, rrjedhimisht edhe zhvillimi i aktivitetit të sektorit kryesisht reflekton ecurinë e kredive si kategoria kryesore në kuadër të strukturës së gjithsej asetëve të këtij sektori.

Kategoria e dytë më e rëndësishme për nga pesha janë lizingjet me pjesëmarrje prej 18.2 përqind në gjithsej asetet e sektorit (figura 40).

### Kreditë

Figura 41. Struktura e aseteve të sektorit mikrofinanciar




Burimi: BQK (2016)

Vlera e gjithsej kredive të sektorit mikrofinanciar në dhjetor 2015 arriti në 82.4 milionë euro, që paraqet rritje të përsheptuar vjetore prej 10.7 përqind (2.9 përqind në dhjetor 2014). Gjatë vitit 2015, kreditë ndaj ndërmarrjeve shënuan normë më të lartë të rritjes vjetore (15.6 përqind) krahasuar me kreditë ndaj ekonomive familjare (8.2 përqind). Megjithatë, ish-in kreditë ndaj ekonomive familjare, si kategoria kryesore e kredive të sektorit mikrofinanciar, ato të cilat dhanë kontributin kryesor në rritjen e gjithsej kredive të lëshuara nga ky sektor.

Kreditë ndaj ekonomive familjare në dhjetor 2015 regjistruan rritje vjetore prej 8.2 përqind, që paraqet rimëkëmbje të theksuar krahasuar me rënien vjetore prej 0.4 përqind të shënuar në dhjetor 2014. Kreditë për ekonomitë familjare përfaqësuan 64.5 përqind të gjithsej kredive të sektorit mikrofinanciar në dhjetor 2015.

Struktura e kredive të ekonomive familjare sipas afatit të maturimit vazhdon të dominohet nga kreditë me afat maturimi ‘mbi 1 deri në 2 vite’ që përfaqësojnë 47.0 përqind të gjithsej kredive, pasuar nga ato me afat maturimi ‘mbi 2 deri në 5 vite’ që përfaqësojnë 29.9 përqind të gjithsej kredive. Kreditë afatshkurtëra ‘deri në 1 vit’ përfaqësojnë 21.4 përqind të gjithsej kredive, ndërsa pjesëmarrjen më të vogël në kreditë ndaj ekonomive familjare e kanë kreditë me afat maturimi ‘mbi 10 vite’ të cilat përfaqësohen me 0.2 përqind (figura 42).

Figura 42. Kreditë ndaj ekonomive familjare sipas maturitetit, në përqindje




Burimi: BQK(2016)

Kreditimi i ndërmarrjeve, gjatë vitit 2015, shënoi rritje vjetore prej 15.6 përqind krahasuar me rritjen prej 9.9 përqind të shënuar në dhjetor 2014. Struktura e kreditimit të ndërmarrjeve sipas sektorëve ekonomik mbetet e ngjashme me periudhat paraprake. Kategoria kryesore mbeten kreditë e destinuar për shërbime tjera të cilat, në dhjetor 2015, përbënë 26.5 përqind të gjithsej kredive të sektorit mikrofinanciar. Për dallim nga sektori bankar, ku kreditë për bujqësinë paraqesin kategorinë me pjesëmarrjen më të ulët, tek institucionet mikrofinanciare bujqësia gëzon një mbështetje më të madhe duke përfaqësuar kategorinë

e dytë për nga pesha, me pjesëmarrje prej 25.4 përqind. Kreditë për ndërtimtari, të cilat kanë një pjesëmarrje prej 19.9 përqind në gjithsej kreditë e sektorit mikrofinanciar, mbeten kategoria e tretë për nga pjesëmarrja në gjithsej kreditë e sektorit mikrofinanciar. Ndërsa, kreditimi i sektorit të tregtisë përfaqëson 18.9 përqind të gjithsej kreditimit mikrofinanciar për dallim nga kreditimi bankar ku ka pjesëmarrjen më të madhe. Sektori i industrisë mbetet sektori me qasjen më të ulët në financimin mikrofinanciar me pjesëmarrje prej vetëm 9.0 përqind (figura 43).

Figura 43. Kreditë e sektorit mikrofinanciar sipas sektorëve ekonomik, në përqindje




Burimi: BQK (2016)

Sa i përket ecures së kreditimit sipas sektorëve të ekonomisë, kreditë për sektorin e tregtisë regjistruan rritjen më të lartë vjetore prej 22.7 përqind në dhjetor 2015 (19.1 përqind në dhjetor 2014). Kreditimi i sektorit të industrisë u karakterizua me rritje vjetore prej 21.7 përqind (20.6 përqind në dhjetor 2014), përderisa kreditimi i sektorit të ndërtimtarisë shënoi rritje vjetore prej 18.3 përqind (12.8 përqind në dhjetor 2014). Rritja më e theksuar kreditimit mikrofinanciar për sektorin e tregtisë në kohën e ngadalësimit të rritjes së kreditimit bankar për

sektorin e tregtisë; si dhe rritja e theksuar e kreditimit mikrofinanciar për sektorin e ndërtimtarisë krahas rënies së kreditimit bankar për këtë veprimtari mund të shërbejë si evidencë për rritjen e aftësisë së sektorit mikrofinanciar për të plotësuar kreditimin bankar dhe në të njëjtën kohë mund të paraqes rritje të presioneve konkurrese të sektorit mikrofinanciar kundrejt sektorit bankar.

Kreditimi i sektorit të bujqësisë gjithashtu shënoi rritje vjetore të përsheptuar prej 15.4 përqind (3.6 përqind në dhjetor 2014) (figura 44). Rritja e theksuar e kreditimit mikrofinanciar dhe bankar të sektorit të bujqësisë gjatë kësaj periudhe mund të jetë si rezultat i dyfishimit të buxhetit të alokuar për këtë sektor nga ana e qeverisë dhe rritjes së theksuar të subvencioneve dhe granteve të USAID dhe Komisionit Evropian për këtë sektor gjatë vitit 2015.

Figura 44. Rritja e kredive të sektorit mikrofinanciar ndaj ndërmarrjeve, sipas sektorëve ekonomik




Burimi: BQK (2016)

Kreditimi për sektorin e shërbimeve tjera, që edhe dominon strukturën e gjithsej kredive, në dhjetor 2015 shënoi rritje vjetore prej 6.4 përqind të ngjashme me vitin paraprak (6.0 përqind në dhjetor 2014).

Struktura e kredive të sektorit ndaj ndërmarrjeve sipas afatit të maturimit vazhdon të jetë e dominuar nga kreditë me maturim afatmesëm. Në dhjetor 2015, kreditë me afat maturimi ‘mbi 1 deri në 2 vite’ me pjesëmarrje prej 42.8 përqind pasuar nga kreditë me afat maturimi ‘mbi 2 deri në 5 vite’ me 40.3 përqind. Kategoria e tretë për nga pesha në strukturë mbeten kreditë afatshurtëra ‘deri në 1 vit’ me 15.6 përqind. Pjesëmarrjen më të vogël në strukturë me 1.2 përqind e kanë kreditë me afat maturimi ‘mbi 5 deri në 10 vite’ (figura 45).

Figura 45. Kreditë ndaj ndërmarrjeve sipas maturitetit, në përqindje




### Lizingjet

Lizingjet si kategoria e dytë për nga pesha në strukturë të aseteve të sektorit mikrofinanciar në dhjetor 2015 arritën vlerën 21.8 milionë euro (figura 46), duke shënuar rënie vjetore prej 2.5 përqind.

Rënia e gjithsej lizingjeve kryesisht i atribuohet rënies së lizingjeve për ekonomitë familjare të cilat shënuan rënie vjetore prej 3.7 përqind në dhjetor 2015. Gjatë vitit 2015, lizingjet për ekonomitë familjare u karakterizuan me rënie si në kategorinë hipotekare ashtu edhe në kategorinë e lizingjeve tjera.

Figura 46. Lizingjet e sektorit mikrofinanciar



Kontributin më të madh në rënien e lizingjeve për ekonomitë familjare e kishin lizingjet hipotekare, të cilat shënuan një rënie vjetore prej 3.7 përqind krahasuar me rritjen vjetore prej 110.8 përqind të shënuar në dhjetor 2014. Lizingjet tjera regjistruan një rënie vjetore prej 2.9 përqind (rritje vjetore prej 15.2 përqind në dhjetor 2014). Lizingjet për ekonomitë familjare diktojnë ecurinë e gjithsej lizingjeve sepse përbëjnë kategorinë dominuese me 52.8 përqind të strukturës së lizingjeve. Struktura e lizingjeve për ekonomitë familjare sipas afatit të maturimit vazhdon të dominohet nga lizingjet afatgjata ‘mbi 10 vite’ me pjesëmarrje 46.8 përqind në strukturë, pasuar nga lizingjet me afat maturimi ‘mbi 5 deri në 10 vite’ me pjesëmarrje prej 39.5 përqind.

Kontribut në rënien e gjithsej lizingjeve, edhe pse më të vogël kishin edhe lizingjet për ndërmarrjet të cilat u karakterizuan me rënie vjetore të lehtë prej 0.9 përqind dhe përbëjnë 46.9 përqind të gjithsej lizingjeve të sektorit mikrofinanciar. Në kuadër të lizingjeve për ndërmarrjet ishte kategoria e lizingjeve për pajisje që ndikoi në rënien e kësaj kategorie. Në të njëjtën kohë, lizingjet tjera, si kategoria më e madhe në peshë (pjesëmarrje prej 83.2 përqind në strukturën

e gjithsej lizingjeve), ndikoi që kjo rënie të jetë jo shumë e ndjeshme për këtë kategori. Deri në dhjetor 2015, lizingjet për pajisje shënuan rënie vjetore më të theksuar prej 36.5 përqind, pasuar nga lizingjet hipotekare të cilat shënuan rënie prej 12.6 përqind. Për dallim nga këto kategori, lizingjet tjera u karakterizuan me rritje vjetore prej 9.8 përqind duke zbutur rënien e ndjeshme të gjithsej lizingjeve ndaj ndërmarrjeve.

Struktura e lizingjeve të ndërmarrjeve sipas afatit të maturimit u dominua nga lizingjet afatmesme ngjajshëm me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Më saktësisht, dominuan lizingjet me afat maturimi ‘mbi 2 deri në 5 vite’ me 89.4 përqind pjesëmarrje në strukturë, pasuar nga lizingjet me afat maturimi ‘mbi 1 deri në 2 vite’ me pjesëmarrje prej 7.6 përqind.

### Detyrimet


Aktiviteti i sektorit mikrofinanciar mbështetet kryesisht në huamarrjen nga sektori i jashtëm. Në dhjetor 2015, gjithsej huamarrjet e jashtme shënuan vlerën prej 62.7 milionë euro, që paraqet rritje vjetore prej 1.4 përqind (rënie prej 1.4 përqind në dhjetor 2014). Rritja e huamarrjeve prej sektorit të jashtëm është reflektuar kryesisht në rritjen e aktivitetit kreditor gjatë kësaj periudhe.

### Normat e Interesit

Norma mesatare e interesit në kreditë e sektorit mikrofinanciar gjatë vitit 2015 shënoi rënie, duke ndërprerë kështu trendin rritës të ndjekur gjatë tri viteve të fundit. Në dhjetor 2015, norma mesatare e interesit në kreditë e sektorit mikrofinanciar u

zvogëlua në 22.3 përqind nga 23.3 përqind sa ishte në dhjetor 2014. Megjithatë, kjo ecuri reflekton kryesisht rënien e normës mesatare të interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve, përdërisa norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare vazhdoi të përcjellë trendin rritës të tre viteve të fundit. Në dhjetor 2015, norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare është rritur në 24.4 përqind nga 23.8 përqind sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Kurse, mesatarja e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve në dhjetor 2015 u zvogëlua në 19.9 përqind (22.6 përqind në dhjetor 2014), që paraqet një rënie prej 2.7 pikë përqindje (figura 47).


Figura 47. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar



Në kuadër të kredive ndaj nërmarrjeve, kreditë ndaj sektorit të shërbimeve u kredituan me normën mesatare të interesit më të ulët nga të gjithë sektorët ekonomik. Kjo kategori njëkohësisht u karakterizua më rënien më të theksuar prej 1.8 pikë përqindje duke arritë në 19.9 përqind në dhjetor 2015 nga 21.7 përqind në dhjetor 2014. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj sektorit të industrisë po ashtu shënoi rënie, duke arritur në 23.6 përqind në dhjetor 2015 nga 23.8 përqind sa ishte në dhjetor 2014. Ndërsa,

norma mesatare e interesit në kreditë ndaj sektorit të bujqësisë mbeti në nivel të ngjashëm me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, duke qëndruar në 25.5 përqind (figura 48). Rënia në normat e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve mund të ketë kontribuar në rritjen e kërkesës së ndërmarrjeve për kredi nga sektori mikrofinanciar.

Figura 48. Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomik



Burimi: BQK (2016)


### Performanca e sektorit mikrofinanciar

Sektori mikrofinanciar u karakterizua me përmirësim të performancës financiare në krahasim me tre vitet e fundit. Deri në dhjetor 2015, sektori mikrofinanciar realizoi profit në vlerë prej 2.5 milionë euro krahasuar me profitin prej 0.7 milionë euro të realizuar në dhjetor 2014. Rritja e theksuar e profitit ishte kryesisht rezultat i rritjes së përshpejtuar të të hyrave, përderisa shpenzimet u rritën me ritëm të ngadalësuar.

Deri në dhjetor 2015, sektori mikrofinanciar realizoi të hyra në vlerë prej 21.1 milionë euro, që paraqet rritje vjetore të konsiderueshme prej 9.4 përqind krahasuar me rritjen prej 0.5 përqind të shënuar deri

në dhjetor 2014. Ndërsa, shpenzimet deri në dhjetor 2015 arritën në 18.7 milionë euro, duke paraqitur një rritje të lehtë prej 0.5 përqind për dallim nga rënia prej 4.9 përqind deri në dhjetor 2014 (figura 49).

Figura 49. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK (2016)

Rritja e përshpejtuar e të hyrave deri në dhjetor 2015 ishte kryesisht rezultat i rritjes së të hyrave nga interesi me rritje vjetore 7.0 përqind (rritje prej 3.3 përqind në dhjetor 2014) dhe të hyrave nga jo interesi me rritje vjetore prej 21.4 përqind (rënie prej 11.4 përqind në dhjetor 2014). Në kuadër të të hyrave nga jo interesi, të hyrat nga shërbimet shënuan rritje vjetore prej 164.9 përqind për dallim nga rritja prej 11.2 përqind në dhjetor 2014. Të hyrat administrative në dhjetor 2015 patën një rritje prej 23.2 përqind në krahasim me rritjen vjetore prej 5.6 përqind në vitin paraprak. Ndërsa, të hyrat tjera operative shënuan rritje të konsiderueshme prej 2.0 përqind në krahasim me rënie prej 18.0 përqind në dhjetor 2014.

Në anën tjetër, rritja e shpenzimeve ishte kryesisht si rezultat i rritjes së shpenzimeve nga jo interesi të cilat në dhjetor 2015 arritën në 12.3 milionë euro rritje prej 0.1 përqind në krahasim me rënie prej 8.5 përqind në vitin paraprak dhe shpenzimeve nga




interesi të cilat arritën në 4.0 milionë euro që paraqet një rritje prej 5.0 përqind (0.3 përqind në dhjetor 2014). Në kuadër të shpenzimeve nga jo interesi, shpenzimet për provizionet për humbjet nga kreditë shënuan rritje të theksuar vjetore prej 8.7 përqind për dallim nga rënia prej 46.7 përqind në dhjetor 2014, ndërsa shpenzimet e personelit dhe administrative u karakterizuan me rënie vjetore prej 0.7 përqind (rënie prej 1.5 përqind në dhjetor 2014). Shpenzimet tjera operative po ashtu shënuan rënie të theksuar prej 4.5 përqind në krahasim me rritjen prej 7.3 përqind në vitin paraprak. Rënie në shpenzimet e personelit dhe në shpenzimet tjera operative ndikuan që të ngadalësohet rritja e shpenzimeve të sektorit mikrofinanciar.

Raporti i shpenzimeve ndaj të hyrave të sektorit mikrofinanciar ka shënuar përmirësim të dukshëm krahasuar me vitin e kaluar. Në dhjetor 2015, ky indikator u zvogëluar në 88.4 përqind, krahasuar me 96.2 përqind sa ishte deri në dhjetor 2014. Kjo ishte si rezultat i rritjes së përshpejtuar të të hyrave të sektorit mikrofinanciar deri në dhjetor 2015 dhe ngadalësimit të shpenzimeve gjatë kësaj periudhe.

Rrjedhimisht profiti i realizuar deri në dhjetor 2015 ndikoj në përmirësimin e konsiderueshëm të treguesve të profitabilitetit ku Kthimi në Mesataren e Aseteve (ROAA) u përmirësua në 2.1 përqind (0.6 përqind në vitin 2014), ndërsa Kthimi në Mesataren e Kapitalit (ROAE) u përmirësua në 7.6 përqind (2.4 përqind në vitin 2014) (figura 50).

Figura 50. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK (2016)

Sektor i mikrofinanciar vazhdon të karakterizohet me nivel relativisht të ulët të kredive jo-performuese dhe nivel të kënaqshëm të provizioneve për mbulimin e kredive jo-performuese. Në dhjetor 2015, pjesëmarrja e kredive jo-performuese në gjithsej kreditë u zvogëluar në 4.2 përqind, në krahasim me normën prej 4.8 përqind sa ishte në dhjetor 2014, ndikuar kryesisht nga ritmi më i lartë i rritjes së stokut të kredive krahas rritjes së vlerës së kredive jo-performuese. Gjithashtu, edhe mbulueshmëria me provizione u përmirësua konsiderueshëm në 124.7 përqind në dhjetor 2015, krahasuar me nivelin prej 113.1 përqind në dhjetor 2014 (figura 50).

---

*Sektor i mikrofinanciar gjatë vitit 2015 u karakterizua me përshpejtim të aktivitetit dhe përmirësim të theksuar të performancës financiare krahasuar me vitet e fundit.*

---

## Tregu i letrave me vlerë


Sipas kalendarit të publikuar nga Ministria e Financave, gjatë vitit 2015 janë mbajtur 21 ankande për emetimin e letrave me vlerë, në vlerë nominale prej 398.6 milionë euro. Numri i përgjithshëm i ankandëve është i njëjtë me vitin 2014, mirëpo vlera nominale e emetuar ishte 302.2 milion euro ose 1.2 përqind më e ulët se sa në vitin 2014.

Gjatë vitit 2015, qeveria e Kosovës ka emetuar numër dhe vlerë më të vogël të bonove të thesarit krahasuar me vitin paraprak. Deri në dhjetor 2015, numri i bonove të thesarit të emetuara ishte 14 krahasuar me 17 deri në dhjetor 2014. Krahas rënies në numër, emetimi i bonove të thesarit tregoi rënie edhe në vlerë në 278.6 milionë euro nga 345.0 milionë euro sa ishte në dhjetor 2014. Në anën tjetër, emetimi i fletëobligacioneve shënoi rritje në numër dhe vlerë gjatë vitit 2015 krahasuar me vitin paraprak. Deri në dhjetor 2015, u emetuan 7 fletëobligacione qeveritare në vlerë prej 119.95 milion euro krahasuar me 4 të tilla në vlerë prej 52.0 milionë euro deri në dhjetor 2014. Për më tepër, gjatë vitit 2015 për herë të parë janë emetuar tri obligacione qeveritare me afat maturimi 3 dhe 5 vite.

Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovë, sipas afatit të maturimit, u karakterizua me ndryshime të theksuara gjatë viteve të fundit. Gjatë katër viteve të fundit, letrat me vlerë me maturitet afatshkurtër kanë ndjekur trend të theksuar rënës kundrejt zgjerimit të theksuar të peshës së letrave me maturitet afatgjatë. Në dhjetor 2015, bonot e thesarit me afat maturimi 364 ditë zgjeruan pjesëmarrjen në 37.6 përqind, duke u

shndërruar në kategorinë kryesore të strukturës së letrave me vlerë. Kjo paraqet një ndryshim të theksuar në strukturën e letrave me vlerë krahasuar me katër vite më parë kur kategoria kryesore, me pjesëmarrje prej 73.2 përqind, ishin bonot e thesarit me afat maturimi 91 ditë (figura 51).

Figura 51. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë, në përqindje



Burimi: BQK (2016)

Kategoria e dytë për nga pesha, me pjesëmarrje prej 22.2 përqind, në dhjetor 2015 ishin bonot e thesarit me afat maturimi 182 ditë, që paraqet kategorinë e cila u karakterizua me ngushtimin më të theksuar të peshës në gjithsej strukturë e letrave me vlerë krahasuar me vitin paraprak.

Fletëobligacionet qeveritare me afat maturimi dy vite në dhjetor 2015 zgjeruan pjesëmarrjen në strukturën e letrave me vlerë në 18.8 përqind, duke u radhitur kështu në kategorinë e tretë për nga pesha. Obligacionet qeveritare me afat maturimi 3 dhe 5 vite së bashku përbënë 11.3 përqind të gjithsej strukturës, edhe pse për herë të parë filluan të emetohen në vitin 2015. Këto zhvillime reflektojnë orientimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës drejt zgjerimit të afatit të maturimit të letrave me vlerë.


Që nga themelimi i tregut të letrave me vlerë në vitin 2012, shuma e ofertuar në shumicën e rasteve ka tejkaluar shumën e shpallur në ankande nga Departamenti i Thesarit në kuadër të Ministrisë së Financave. Në dhjetor 2015, raporti në mes të shumës së ofertuar dhe asaj të shpallur në ankande ishte 1.55 herë më i lartë. Ky raport është më i lartë në këtë vit krahasuar me vitin paraprak (1.36 herë deri në dhjetor 2014) kryesisht si rezultat ofertimit më të lartë nga ana e pjesëmarrësve në ankande krahas shumës më të ulët të shpallur nga ana e qeverisë gjatë vitit 2015 në krahasim me vitin 2014. Ky raport reflekton interesimin e lartë të subjekteve pjesëmarrëse, kryesisht të sektorit bankar, në tregun e brendshëm në kushtet kur mundësitë për investime në letrat me vlerë të qeverive të huaja janë më pak atraktive si rezultat i normave të ulëta mbizotëruese në këto tregje.

bartin norma të interesit më të larta krahasuar me ato të bonove të thesarit.

Gjatë vitit 2015, norma më e lartë e interesit prej 4.9 përqind u regjistrua në obligacionet me afat maturimi 5 vite, ndërsa norma më e ulët prej 0.6 përqind u regjistrua në bonot e thesarit me afat maturimi 91 ditë.

Vlen të theksohet se gjatë vitit 2015, norma mesatare e interesit në bonot e thesarit me afat maturimi 182 dite u karakterizua me rritje, përderisa, norma mesatare e interesit në bonot e thesarit me afat maturimi 364 ditë shënoi rënie të lehtë. Ndërsa, norma mesatare e interesit në bonot e thesarit me afat maturimi 91 ditë dhe atyre me afat maturimi prej 2 vite nuk ka ndryshuar krahasuar me vitin paraprak (figura 52).

Figura 52. Normat e interesit të letrave me vlerë të Qeverisë sipas maturimit, në përqindje



Norma e përgjithshme mesatare e interesit në letrat me vlerë gjatë 2015 ishte më e lartë (1.94 përqind) krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (1.57 përqind). Në rritje kontribuoi emetimi për herë i parë të obligacioneve 3 dhe 5 vjeçare, të cilat edhe

### **Citimi i sygjeruar i këtij publikimi:**

BQK (2016): Vlerësimi Ekonomik Tremujor Nr. 13 TM4 2015, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Prishtinë

### **Referencat:**

BQK (2016):

- a) Buletini Mujo Statistikor: <http://bqk-kos.org/?id=97>
- b) Statistikat zyrtare të BQK-së, Seritë kohore: <http://www.bqk-kos.org/?cid=1,124>
- c) Shpalljet dhe Rezultatet e ankandevë për letra me vlerë të qeverisë: <http://www.bqk-kos.org/?cid=1,163>

ASK (2016):

- a) Indeksi i çmimeve të konsumit: [http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat\\_view/98-cmimet/15-indeksi-i-cmimeve-te-konsumit-](http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/15-indeksi-i-cmimeve-te-konsumit-)
- b) Indeksi i çmimeve të prodhimit: [http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat\\_view/98-cmimet/79-indeksi-i-cmimeve-te-prodhimit-](http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/79-indeksi-i-cmimeve-te-prodhimit-)
- c) Indeksi i çmimeve të importit: [http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat\\_view/98-cmimet/80-indeksi-i-cmimeve-te-importit-](http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/80-indeksi-i-cmimeve-te-importit-)
- d) Reportori Statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike: <http://esk.rks-gov.net/regjistri-statistikor-i-bizneseve/publikimet>
- e) Statistikat e tregtisë së jashtme: <http://esk.rks-gov.net/tregtia-e-jashtme/publikimet>

Bloomberg (2016): Metal Prices database.

FAOUN (2016): World Food Prices, Food and Agriculture Organization of United Nations: <http://www.fao.org/worldfoodsituation/foodpricesindex/en/>

Euribor (2016): Euribor Historical Rates:

<http://www.euribor-ebf.eu/euribor-org/euribor-rates.html>

IMF (2016): World Economic Outlook:

<http://www.imf.org/external/pubs/ft/weo/2015/02/weodata/index.aspx>

## Treguesit e zgjedhur makroekonomik

Përshkrimi	Dhjetor 2014	Dhjetor 2015
Sektori real 1/		
PBB (në milionë euro)	5,567.5	5,755.1
Çmimet (mesatarja vjetore)	0.4%	-0.5%
Çmimet (fundi i periudhës)	-0.5%	-0.2%
Sektori fiskal 2/		
Të hyrat (në milionë euro)	1,332.8	1,456.8
Shpenzimet (në milionë euro)	1,475.8	1,567.0
Bilanci, si përqindje e PBB-së	-2.6	-1.9
Sektori financiar (në milionë euro) 3/		
Asetet e korporatave financiare	4,529.4	4,894.9
prej të cilave: Bankat	3,185.7	3,387.3
Kredi	1,882.4	2,019.4
Depozita	2,537.5	2,701.4
Norma e interesit në kredi, fundi i periudhës	9.3	7.7
Norma e interesit në depozita, fundi i periudhës	1.1	1.2
Hendeku i normës së interesit	8.2	6.5
Sektori i jashtëm, (në milionë euro) 3/		
Bilanci i pagesave*		
Llogaria rrjedhëse dhe kapitale	-393.9	-469.9
prej të cilave: remitencat e pranuar	626.3	682.7
Llogaria financiare	-91.6	-223.7
Investimet e huaj direkte në Kosovë	159.9	316.3
Investimet portfolio, net	91.5	7.2
Investimet tjera, net	-84.4	-27.1
Pozicioni ndërkombëtar i Investimeve, net**	380.4	151.3
Asetet	4,302.2	4,496.0
Detyrimet	3,921.8	4,344.7
Borxhi i jashtëm, gjithsej	1,709.0	1,911.7
Borxhi i jashtëm privat	1,325.6	1,474.9
Borxhi i jashtëm publik	383.4	436.8

Burimi:

1/ ASK (2015).

2/ MF (2015).

3/ BQK (2015).

\*Për bilancin e pagesave, të dhënat janë deri në nëntor.

\*\*Për PNI dhe borxhin e jashtëm, të dhënat janë deri në shtator.

